


UDHËZUES PËR PLANIFIKIMIN E MËSIMIT NË SHKOLLAT PROFESIONALE



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



UDHËZUES PËR PLANIFIKIMIN E MËSIMIT NË SHKOLLAT PROFESIONALE

Tetor 2020

Ky publikim është prodhuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J) nën mbikqyrjen e Menaxherit të Projektit, Fation Dragoshi. Materiali u përgatit nga Shqipe Shyti dhe Gerda Sula.

Rreth projektit “Aftësi për Punë”

“Aftësi për Punë” (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Autorësia e këtij publikimi i përket projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga S4J.

AFTËSI PËR PUNË S4J

Rruga Skënderbej, Vila nr. 49
Tiranë, Shqipëri, Kutia Postare 2891
Tel: +355 42 231 850
e-mail: al.info@swisscontact.org
www.aftesiperpune.al

Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	2
Për kë është ky manual?.....	5
Si është strukturuar ky manual?.....	5
Pjesa I - Çfarë është planifikimi?.....	6
Pse është i rëndësishëm planifikimi?.....	7
Çfarë na nevojitet kur planifikojmë?.....	8
Cilat janë parimet e planifikimit?.....	9
Pjesa II: Planifikimi i mësimi.....	11
Qëllimi dhe konceptet.....	11
Konceptimi.....	11
Konteksti.....	12
1. Planifikimi në lëndët e përgjithshme.....	12
2. Lëndët teorike të drejtimit profesional.....	13
3. Modulet e praktikës profesionale.....	13
Si (duhet të) procedohet për planifikimin?.....	14
Elementë të organizimit të planit sipas udhëzimeve.....	14
Politika të përgjithshme.....	14
Plan vjetor i lëndëve të formimit të përgjithshëm.....	14
Plan vjetor i lëndëve teorike profesionale.....	16
Plani vjetor i praktikës profesionale.....	17
Përbërësit e planit.....	17
Metodologjia.....	17
Teknologjia.....	18
Veprimtaritë.....	19
Vlerësimi.....	19
Burime dhe materiale.....	20
Përmbledhje.....	21
Planifikimi vjetor.....	21

Detyra dhe përgjegjësi.....	21
Mësuesi	22
Ekipet lëndore dhe Njësia e zhvillimit	22
Drejtoria.....	22
Hartimi i matricës për zbrëthimin e kompetencave të përgjithshme përgjatë kurrikulës	23
Aftësitë e buta	23
Pjesa III - Modele planesh vjetore e ditore dhe instrumente vlerësimi.....	25
Plan i moduleve profesionale	25
Model plani vjetor	25
Programi i mësimdhënies së moduleve praktike profesionale	26
Planifikimi i teorisë profesionale	31b
Varianti - mësim në distancë	34
Plani vjetor mësimor i lëndëve të kulturës së përgjithshme	39
Planifikimi i projekteve ndërlëndore	50
Planifikimi i punës me projekte	50
Plani i mësimit PBL.....	52
Plani ditor- udhëzime	55
Plani ditor formate	56
1. Plan ditor për lëndë të përgjithshme.....	56
2. Plan ditor: Lëndë teorike profesionale	58
Plan ditor : Module profesionale.....	59
Plani individual i punës në biznes.....	60
Instrumente vlerësimi për planifikimin	62
Listë kontrolli për vlerësimin e planifikimit në lëndët e formimit të përgjithshëm	62
Listë kontrolli për vlerësimin e programeve të mësimdhënies të moduleve profesionale.....	63
Listë kontrolli për vlerësimin e programeve mësimore në lëndët e teorisë profesionale	65
Fjalorth.....	68
Shtojca	70
Bibliografi:.....	75

Hyrje

Për kë është ky manual?

Ky manual është i hartuar për t'i ardhur në ndihmë mësuesve të arsimit profesional, me qëllim planifikimin e procesit mësimor në lëndët e kulturës së përgjithshme, lëndëve të teorisë profesionale dhe moduleve të praktikës, në funksion të arritjes së qëllimit të AP.

Ky manual përmban formate planesh vjetore, planesh ditore (ditar), instrumente vlerësimi për planet, të konceptuara nga vetë mësuesit e AP.

Si është strukturuar ky manual?

Në pjesën e parë trajtohen koncepte të përgjithshme, si: ç'është planifikimi, parimet e planifikimit, rëndësia e tij, duke synuar ndërgjegjësimin e mësuesve për rëndësinë e planifikimit si proces vendimtar në ecurinë e punës gjithëvjetore.

Në pjesën e dytë të manualit analizohen qëllimet, konteksti, elementët e planifikimit dhe politikat e përgjithshme të hartimit të planeve, duke u mbështetur në bazën ligjore të APU.


Në pjesën e tretë jepen formate dhe modele të sugjeruara të planit vjetor e ditore, duke u mbështetur në bazën ligjore, përvojën e mësuesve të shkollës dhe pedagogjinë bashkëkohore.

Ky manual përmban dhe një fjalorth, që synon të qartësojë terminologjinë që përdoret sot në edukim dhe në udhëzuesit shtetërorë për kurrikulën e AP, si dhe shtojcat në të cilat është paraqitur baza ligjore në të cilën mbështetet planifikimi i mësimi.

Pjesa I - Çfarë është planifikimi?

Mendojeni procesin mësimor gjithëvjetor si një rrugëtim nëpër shtigje ku çdo ditë mësohet diçka e re.

Një planifikim i mirë bën që ky rrugëtim të jetë i këndshëm dhe t'i udhëheqë nxënësit në destinacionin e dëshiruar. Planifikimi është si të përpiloni një itinerar, ku do të përcaktohen jo vetëm rrugët nëpër të cilat do të udhëtoni, por dhe të gjitha pikat e rëndësishme ku do t'ju duhet të ndaloni më gjatë, materialet dhe burimet që do të përdorni në pjesë të caktuara të rrugës, si dhe shpejtësinë me të cilën do t'ju duhet të rrugëtoni. Të gjitha rubrikat që do të pasqyroni, do të shërbejnë si një legjendë për itinerarin e përpiluar nga ju.




Mbani mend!

Planifikimi jo efikas e bën punën e mësuesit të paqëllimshme dhe bëhet shkak për sjellje jo të përshtatshme nga nxënësit.

Pse është i rëndësishëm planifikimi?

Për të ndihmuar nxënësit të arrijnë rezultatet e të nxënit, mësuesi duhet të bëjë një planifikim efektiv të mësimit që do të zhvillojë gjatë gjithë vitit, i cili duhet të jetë i mirëmenduar për të përfshirë nxënësit në arritjen e kompetencave të lëndës dhe atyre të përgjithshme (kyçe).



Përfitimet për mësuesin:

- I redukton stresin;
- Bën të mundur sigurimin e materialeve të duhura ;
- E bën punën më të lehtë e tërheqëse;
- Tregon profesionalizëm;
- I jep një ndjenjë vetëpërmbushje e arritjeje;

Përfitimet për nxënësit:

- I kanë të qarta pritshmëritë;
- Ju zvogëlon tensionin dhe sjelljen e papërshtatshme;
- Ju zhvillohet sensi kohës;
- Mësojnë aftësitë e duhura për profesionin e tyre;
- Ju pakëson ankthin.

Përfitimet për drejtuesit:

- Ndjehen më të sigurt në arritjen e qëllimeve të shkollës;
- E kanë më të lehtë organizimin e menaxhimin e situatave;
- Janë më të qartë në kërkesat e mbështetjen e mësuesve;
- Dinë si të orientojnë kërkesat dhe pritshmëritë e nxënësve.

Çfarë na nevojitet kur planifikojmë?

Çdo mësues gjen të përshkruara në aktet ligjore dhe nënligjore për APU në Shqipëri, një set me detyra dhe përgjegjësi për planifikimin e mësimit, për detyrat dhe përgjegjësitë e tij në procesin mësimor (DN, Udhëzimet e ASCAP, AKAFPK), por puna konkrete me nxënësit, shtrun para mësuesve një sërë veçantish e përgjegjësish, të cilat i tejkalojnë udhëzimet e shkruara.

Në një proces kaq të rëndësishëm, pyetja: *“Çfarë duhet të dinë, të kuptojnë, të çmojnë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit e mi në lëndën që unë jap mësimit?”*, duhet të paraprijë punën e secilit mësues.

Është kjo pyetja që çdo mësues duhet t’ia bëjë vetes me qëllim që të planifikojë në mënyrë të suksesshme. Për këtë është e nevojshme të njihen elementet kryesore që përbëjnë planifikimin e mësimit.

Kërkesat e lëndës. Cilat janë kërkesat e lëndës? Programet e lëndës, kornizat kurrikulare dhe udhëzuesit e MASR, ASCAP, AKAFPK japin të dhëna të plota mbi kërkesat e lëndës, që nga qëllimi i lëndës, njohuritë, aftësitë, shprehjet që duhet të zotërohen nga nxënësit në fund të ciklit mësimor e deri te rezultatet mësimore që duhet të arrijë nxënësi.

Nxënësit: Kush janë nxënësit me të cilët unë do të punoj? Për këtë duhet mësuesi duhet të njohë: nevojat akademike, sociale, fizike, personale dhe emocionale të nxënësve të tij, pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve, si dhe njohuritë që mund të jenë sfiduese për ta, karakteristikat e nxënësve, përfshirë aftësinë e tyre, nevojat, interesat dhe përvojat e mëparshme. Për të mbledhur këtë informacion, mësuesi duhet të bisedojë dhe me kolegët e tjerë dhe të shikojë dosjet e grumbulluara, nëse nxënësit janë në vazhdim të shkollës dhe rezultatet e shkollës 9-vjeçare, nëse nxënësit sapo kanë filluar shkollën.

Mjedisi fizik: Në cilat mjedise do të zhvillohet procesi mësimor? Mësuesi duhet të jetë i njohur me të gjitha mundësitë që shkolla ofron për zhvillimin e procesit mësimor dhe të përpiqet të organizojnë mësimin në një mjedis që bën të mundur realizimin efikas të mësimit (klasë, laborator, klasë e kombinuar, bazë didaktike, etj..) dhe nxitjen e emocioneve pozitive, duke marrë parasysh rregullimin e këtij mjedisi, në mënyrë që nxënësit të mund të shohin tabelën, TV (screen), që hapësirat të jenë të shfrytëzueshme, si dhe vendet ku do të mbahen mjetet e materialet e nevojshme për realizimin e mësimit të jenë lehtësisht të aksesueshme.

Arsyetimi: Cilat qëllime/synime/objektiva do të përmbushen? Cilat janë kërkesat sociale për këtë lëndë (kompetencat e përgjithshme, psh: bashkëpunimi, të dëgjuarit, të ndash gjëra, të ndjekësh udhëzimet)? Si mund t’i ndihmoj nxënësit t’i arrijnë këto kërkesa? Në këtë mënyrë mësuesi nuk do të jetë thjesht “transmetues njohurish”, por një lehtësues i të nxënit për nxënësit, ndërkohë që përmbush kërkesat shtetërore të kurrikulës shkollore.

Duke u nisur nga sa më sipër, mësuesi mund dhe duhet të planifikojë në planin e tij:

Strategjitë: Do të përzgjidhen ato strategji mësimore që e lehtësojnë më shumë të nxënit e RM/objektivave/rezultateve të të nxënit të parashikuara. Përzgjedhja e strategjive të

mësimdhënies bën të mundur që mësuesi të parashikojë situatat e të nxënësve, metodat, veprimtaritë, organizimin dhe mënyrën më të mirë të vlerësimit për arritjen e synimeve.

Kohën: Sa kohë mësimore nevojitet për përmbushjen e veprimtarive të planifikuara? Duke marrë parasysh specifikën e shkollave profesionale, shumë nga veprimtaritë mësimore mund dhe duhet të realizohen në mjedise dhe kohë që e tejkalojnë mësimin e zakonshëm prej 45 minutash në një klasë të zakonshme.

Materialet: Cfarë materialesh dhe burimesh njerëzore nevojiten për një mësim të suksesshëm?

Vlerësimin: Cila është mënyra më e mirë për të matur njohuritë, aftësitë, shprehjet që synohet të arrihen nga mësimi?

Cilat janë parimet e planifikimit?

Që planifikimi të jetë i suksesshëm, ka nevojë për njohjen dhe vënien në zbatim të parimeve të tilla si: vendosja e synimeve të qarta, larmishmëria, përputhshmëria, fleksibiliteti dhe integrimi.

Synimet. Synimet e vendosura për lëndën duhet të jenë të qarta. Këto synime duhet të jenë realiste, të motivojnë nxënësit tuaj dhe të jenë në funksion të qëllimit të edukimit.

Larmishmëria. Mësuesit duhet të përdorin një larmishmëri veprimtarish gjatë mësimin. Përsëritja e veprimtarive të njëjta i mërzhit dhe i demotivon nxënësit, e bën mësimin monoton.

Fleksibiliteti. Gjatë orës mësimore, por dhe gjatë periudhës shkollore mësuesit hasen me situata të papritura, që nga evidentimi i vështirësive në marrjen dhe kuptimin e koncepteve nga nxënësit e deri në ndryshimin e situatave në një kontekst më të gjerë (rasti i pandemisë). Në këtë kontekst, mësuesi duhet të jetë i aftë ta përshtasë planin e tij përgjatë kohës, duke iu përgjigjur jo vetëm situatave të ndryshme, por edhe reagimit të nxënësve.

Përputhshmëria. Planet duhet të jenë në përputhje me kërkesat shtetërore të parashtruara në udhëzuesit kurrikularë, me specifikat e shkollës dhe me nevojat e nxënësve. Kjo punë duhet të mendohet që në planet vjetore, duke pasqyruar në këtë mënyrë dhe veçantinë e një plani nga një tjetër (plani mësimor për të njëjtën lëndë duhet të jetë i ndryshëm nga një shkollë në tjetrën, por edhe brenda shkollës, nga një klasë në tjetrën).


Integrimi. Planet duhet të pasqyrojnë lidhjet e mundshme mes disiplinave. Duke njohur dhe përmbajtjen e lëndëve të tjera që zhvillohen në shkollë, bëhet i mundur planifikimi në kohë të përshtatshme i projekteve lëndore e ndër-lëndore, pa kaluar në përsëritje të informacionit të njëjtë në kohë të ndryshme dhe në lëndë të ndryshme, duke e parë dijen si një të tërë dhe jo të fragmentuar.

Duke patur parasysh sa më lart, plani do të sigurojë:

- Vijueshmëri të mësimdhënies;
- Përdorim efektiv të kohës;
- Plotësimin e nevojave të nxënësve;
- Ndjekjen e udhëzuesve shtetërorë.

- Menaxhimin dhe përdorimin efikas të mjediseve të shkollës sipas specifikave të lëndës e orës mësimore, të pajisjeve hardware e software dhe të logjistikës që disponon shkolla ;
- Realizimin e projekteve ndërlëndore në bazë klase e shkolle.

REZULTATET E NJË PLANIFIKIMI TË MIRË



Pjesa II: Planifikimi i mësimit

Qëllimi dhe konceptet

Të gjithë mësuesit kanë një qëllim kur japin mësim, por mësuesit i përzgjedhin qëllimet në mënyra të ndryshme sipas vlerave që duan t'i transmetojnë nxënësve të tyre. Për shembull, disa mësues kanë qëllim që t'i mbajnë të zënë dhe të qetë derisa të bjerë zilja. Të tjerë kanë si qëllim që nxënësit të merren me tekstin shkollor dhe përmbajtjen e tij gjatë gjithë kohës. Vlera e këtyre qëllimeve është e diskutueshme, sepse këta mësues mund të dështojnë në identifikimin e rezultateve të të nxënësve që janë me vlerë për nxënësit.

Qëllimet janë deklarata të gjera të synimeve edukative, të shprehura në Nenin 3 të Ligjit 69/2012 për APU në RSH. Ato në përgjithësi përshkruhen në terma të përgjithshme abstraktë në dokumentacion ligjor, por në kontekstin shkollor duhet të specifikohen e detajohen në varësi të shkollës, lëndës dhe shkallës së kurrikulës.

Në AP prioritetet e mësimdhënies konsistojnë në tre drejtime:

- Aftësimi në profesionin e zgjedhur;
- Zotërimi i njohurive, si mësimdhënia e koncepteve e fakteve në lëndët e formimit të përgjithshëm e profesional;
- Zhvillimi i vlerave morale e shpirtërore të nxënësve.

Këto priorite duhet të udhëheqin mësuesit e AP në vendosjen e qëllimeve të qarta, duke marrë parasysh 3 burime për gjenerimin e tyre:

- **Nxënësi** si burim i qëllimeve: - *A jam unë duke zhvilluar të rritur të shëndetshëm e funksionalë me mësimdhënien time?*
- **Shoqëria** si burim i qëllimeve: - Shkolla të ndihmojë nxënësit të përballojnë sfidat e shoqërisë në mënyrë efektive. Një fokus i rëndësishëm i këtij theksimi është të ndihmojë nxënësit të kuptojnë proceset abstrakte si: matematika e leximi dhe potencialin e tyre për t'u përdorur në botën reale.
- **Disiplinat shkollore** si burim i qëllimeve - *Cila njohuri është më e rëndësishme për të kuptuarit e përmbajtjes së fushave të ndryshme?*

Konceptimi

Planet mësimore na ndihmojnë për të parashikuar sesi do të jepet përmbajtja e fushave të ndryshme përgjatë vitit shkollor. Mësuesit, në varësi të lëndës që japin, duhet të shqyrtojnë që në fillim të vitit përmbajtjen e lëndës. Disa lloj përmbajtjesh janë më të vlefshme se disa të tjera për të ndihmuar nxënësit që të kuptojnë botën rreth tyre. Këto ide quhen abstraksione (koncepte dhe përgjithësime). Përmbajtja mësimore përfshin gjithashtu dhe një seri faktesh, shumica e të cilave konsiderohet e nevojshme për jetën në shoqërinë e sotme moderne.

Mësuesi gjatë planifikimit të tij duhet të evidentojë pikërisht se cilat fakte, koncepte apo përgjithësime janë më të rëndësishme për të kuptuarit e një disipline dhe cila është mënyra më

e mirë për trajtimin e tyre, me qëllim që nxënësit t'i kuptojnë dhe vënë në përdorim në situata reale.

Pra, në dimensionin konceptual, përmbajtja e një viti ose semestri theksohet, me qëllim që të shërbejë si një kornizë për plane më të detajuara që do të vijnë më vonë (planin ditor).



Mësimdhënia në shkollat profesionale zhvillohet në përputhje me Ligjin 69/2012 e APU në RSH, Dispozitat Normative [Neni 30 për mësuesit e lëndëve profesionale (teori praktikë), Neni 71 për mësuesit e lëndëve të përgjithshme] ([SHIH SHTOJCA 1](#)), udhëzuesit kurrikularë të ASCAP dhe në programet e lëndëve teorike e përshkruesit e moduleve të AKAFPK.

Në të tre përbërësit e kurrikulës në AP, planifikimi i mësimdhënies duhet të bazohet jo vetëm në qëllimet e shprehura në udhëzuesit përkatës, por dhe në një proces analize fillestare, i cili duhet të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si: niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore, mundësitë dhe kushtet e biznesit për realizimin e praktikës së nxënësve, etj.

Në këtë kontekst, për të tre drejtimet duhet të theksohet përmbajtja e një viti që do të shërbejë si një kornizë me plane më të detajuara që do të vijnë më vonë. Gjatë verës mësuesit duhet përgatiten për vitin e ri shkollor, duke shqyrtuar librat, materialet mësimore, udhëzuesit kurrikularë. Bazuar në këto materiale, duke pasur parasysh qëllimin e lëndës, ata duhet të skicojnë lista me tema, sipas një vijueshmërie logjike, si dhe koncepte të rëndësishme për lëndën e tyre, duke qartësuar në këtë mënyrë dhe strategjitë e materialet e dhura për rrugëtimin e tyre gjatë gjithë vitit.

1. Planifikimi në lëndët e përgjithshme

Marrim si shembull lëndën Gjuhë Shqipe:

Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit: fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime rreth sistemit gjuhësor të shqipes; fitojnë njohuri dhe shkathtësi për të komunikuar në mënyrën e duhur (të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit).

Gjithashtu, për lëndët e kulturës së përgjithshme në udhëzuesit kurrikularë jepen dhe kompetencat e përgjithshme dhe ato të lëndës që duhet të përmbushë nxënësi gjatë shkollimit. Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës, mësuesi duhet të ndjekë këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- përcakton rezultatin e të nxënit të kompetencave kyçe për vitin mësimor duke zbërthyer rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe për shkallë mësimore (janë përcaktuar në program);
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit mësimor.

2. Lëndët teorike të drejtimit profesional

Në lëndët teorike të drejtimit profesional, marrim si shembull drejtimin “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi-TIK”, niveli I, është “zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me drejtimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit”.

Synimet e lëndës: “Bazat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit”, kl. 10. Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit” në kl.10, nxënësit duhet të arrijë synimet e listuara në programin e lëndës.

Mbështetur në qëllimin e përcaktuar për drejtimin, mësuesi i lëndës duhet të vendosë për lëndën e tij një qëllim më të specifikuar duke u fokusuar në përmbajtjen e lëndës.

3. Modulet e praktikës profesionale

(shembull profili “Reception”)

Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Reception (pilot)”, niveli II, të drejtimit “Hoteleri -Turizëm”. Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Reception (pilot)”, niveli II, të drejtimit “Hoteleri -Turizëm”, është “zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e receptionit në hotele. Ndërsa ky qëllim i pasqyruar në udhëzuesit kurrikularë është i vlefshëm për drejtimin “Reception”, mësuesi i praktikës profesionale, në

varësi të modulit që do të zhvillojë, do të duhet ta specifikojë më tej këtë qëllim, duke e bërë më konkret dhe të arritshëm.

Si (duhet të) procedohet për planifikimin?

Më poshtë jepen hapat që duhet të ndjekë çdo mësues për planifikimin vjetor të mësimit:

- Shqyrtimi i udhëzuesve kurrikularë.
- Studimi i temave/çështjeve që do trajtohen gjatë vitit.
- Analizë e kompetencave që duhet të arrijë nxënësi në këtë lëndë.
- Analizë e teksteve shkollore/përzgjedhja e teksteve që plotësojnë më mirë kërkesat e kurrikulës.
- Analizë e nivelit dhe formimit të nxënësve.
- Shqyrtim i sugjerimeve që jepen në udhëzues për orët mësimore dhe veprimtaritë.
- Dizajnimi i planeve vjetore në përputhje me kërkesat e kurrikulës, nevojat e nxënësve.

Elemente të organizimit të planit sipas udhëzimeve

Politika të përgjithshme

Udhëzuesit kurrikularë për lëndët e kulturës së përgjithshme, lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikës profesionale na paraqesin politikat e përgjithshme, të cilat duhet të drejtojnë punën për planifikimin e mësimit përgjatë vitit shkollor.

Modelet e mëposhtme paraqesin formatet e kërkuara për të tri fushat e AP.

Plan vjetor i lëndëve të formimit të përgjithshëm

Shkolla profesionale:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi

Lënda: Letërsi; Klasa 11

VITI SHKOLLOR: 2018-2019

Qëllimet e programit të lëndës (nxënësit lexojnë, interpretojnë vepra, vlerësojnë vepra, analizojnë, zbulojnë kënaqësinë e të lexuarit, lidhin tekstin me përvojat e tyre, interpretojnë vlerat e veprave, aftësohen për të qenë qytetarë të denjë).

Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës:

	Përdorimi i orës mësimore	Orë	%
A	Njohuri të reja	24	70.6
B	Përpunim i njohurive	10	29.4
1	Përsëritje	2	5.9
2	Ese	2	5.9
3	Projekt kurrikula	3	8.8
4	Test	3	8.8

Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës

Nr	Tematika	Shtator- Dhjetor Orët 1-14	Janar- Mars Orët 15-25	Prill-Qershor Orët 27-34
1	Letërsia dhe gjinitë letrare	Temat		

Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen në lëndën e letërsisë gjatë shkallës së pestë:

1. Kompetenca e komunikimit
 - Lexon rrjedhshëm një tekst me 1-3 paragrafë.
2. Kompetenca e të menduarit
 - Ofron argumente aktuale në lidhje me temën përkatëse.
3. Kompetenca e të nxënit
 - Demonstron shkathtësi funksionale në lexim/shkrim; përgatit me sukses përmbledhje të dosjes.
4. Kompetenca për jetë, sipërmarrjen dhe mjedisin
 - Harton një projekt me faza të mirëmenduara.
5. Kompetenca personale
 - Merr pjesë në aktivitete e lojëra.
6. Kompetenca qytetare
 - Demonstron shembuj të pjesëmarrjes demokratike.
7. Kompetenca dixhitale
 - Përdor mjete dixhitale/zhvillon aftësitë krijuese.

Kompetencat e lëndës

Analizë e interpretim tekstesh letrare njohuritë (*interpretion dhe analizon elementët e përmbajtjes dhe të formës së një teksti në prozë, si: tema dhe motivet, idetë, përshkrimi i kohës dhe mjedisit, rrëfimtari, marrëdhëniet mes personazheve, fabula dhe subjekti (personazhet/kontekstet historike/reflektimi ndaj tekstit/vlera dhe qëndrime).*

Vlerësimi i letërsisë në periudha të ndryshme letrare - Rn: njohuritë: Gëte, Bajron

Nr	Tematika	Orë	Tema	Situata e të nxënët	Metodologjia	Vlerësim i:	Burime dhe mjete
1	Letërsia dhe gjinitë letrare	1	Zhvillimi historik i gjinisë epike	Diskutim rreth...	Hulumtim	Vlerësim për prezantimet	Teskti shkollor, E-libri, tekst nga Vedat Kokona, video projektor

Plan vjetor i lëndëve teorike profesionale

Në lëndët teorike profesionale plani duhet të përmbajë:

Shkolla profesionale:

Drejtimi profesional: Ekonomi- Biznes, Niveli I.

Lënda: Ekonomi Ndërmarrje (L-17-069-18) KLASA 10

VITI SHKOLLOR: 2018-2019

Synimet e lëndës:

Lënda "Ekonomi ndërmarrje" synon që nxënësit:

- Të shpjegojnë konceptin e ndërmarrjes dhe karakteristikat e saj.
- Të shpjegojnë kuptimet e ndryshme të konceptit të menaxherit.

Nr	Temat/Koha	Çështjet	Koha	Objektivat mesimore kryesore	Metodat mësimore	Instrumentat e vlerësimit	Kërkesa per realizim, vendi
1	Ndërmarrja në ekonominë e tregut (20 orë)	Ndërmarrja dhe sipërmarrësit në ekonominë e tregut	2	-Të shpjegojë termin sipërmarrës	Lexim i drejtuar Diagrama piramidale	Kuic	

Plani vjetor i praktikës profesionale

Çdo plan vjetor i praktikës duhet të përmbajë:

Shkolla Profesionale _____

Qyteti: _____

Viti shkollor: 2018-2019

Drejtimi/Profili profesional: _____, Niveli II, klasa 12

Mësuesi: _____

Lënda: _____

Orë gjithsej: orët totale të praktikës

Module: Numri i moduleve për lëndën

Moduli 1: *Emri i modulit*

Orë gjithsej: _____

Periudha kohore (20 shtator- 30 nëntor)

Nr	Rezultatet mësimore/ periudha	Veprimtaritë mësimore	Lloji	Koha/ Orë mësimore	Instrumentet e vlerësimit	Vendi	Kërkesa për realizimin
1	-plotësohen duke u mbështetur në skelet kurrikul	-plotësohen duke u mbështetur në skelet kurrikul			Listë kontrolli		
2							
3							

Për një planifikim në përputhje me udhëzuesit zyrtarë dhe sa më pranë nevojave të shkollës, në vijim do të jepen sugjerime konkrete për planet vjetore e ditore të mësuesve, me qëllim lehtësimin e punës së mësuesit dhe përmbushjen e funksionit të shkollës në formimin dhe aftësimin e nxënësve si profesionistë të ardhshëm e si qytetarë të denjë të një shoqërie moderne.

Përbërësit e planit

Metodologjia

Në formatet zyrtare të planit vjetor të mësimin, një element i rëndësishëm që ndihmon në harmonizimin e komponentëve të mësimin dhe krijon bazën e hartimit të planit mësimor është rubrika e metodologjisë së mësimdhënies, e shprehur si më poshtë:

1	Lëndët e kulturës së përgjithshme	Metodologjia
2	Lëndët teorike profesionale	Metodat mësimore
3	Modulet e praktikave profesionale	Nuk kërkohet, por janë të planifikuara veprimtaritë mësimore dhe lloji i veprimtarisë.

Duke përcaktuar metodologjinë e mësimdhënies, metodat dhe veprimtaritë që do të zhvillojë, mësuesi *përkthen kompetencat, RM apo Objektivat, në përvoja pozitive të të nxënësve për nxënësit e tij, bën të mundur modifikimin e mësimin për t'iu përshtatur çdo nxënës si nga ana e dijes, po ashtu dhe nga ajo emocionale, sociale dhe fizike. A është kjo metodologji e duhura për t'u mësuar nxënësve atë që është e përcaktuar në udhëzuesit kurrikularë?*

Pavarësisht qëllimit mësimor: mësimin të koncepteve, përgjithësimeve, përkufizimeve, fakteve, të domosdoshme në kulturën e përgjithshme apo lëndët teorike profesionale, mësimin të aftësive e shprehive praktike në modulet profesionale, secili mësues duhet të përcaktojë qartë dhe saktë se cila metodë realizon më mirë synimet/objektivat/rezultatet mësimore të përcaktuara në udhëzuesit kurrikularë. Metoda e përzgjedhur duhet të jetë në funksion të qëllimit të lëndës.

Teknologjia

Për vite me rradhë tabela e zezë dhe shkumësi kanë qenë të vetmet mjete ndihmëse për mësuesin gjatë procesit mësimor dhe në rastin praktikave, puna direkte në bazë. Sot, ka një sërë burimesh moderne të mundshme e të arritshme për mësuesin. Teknologjia na siguron sot një larmishmëri në mësimdhënie, më interesante për nxënësit dhe më lehtësuese për mësuesin, por sigurisht nëse përdoret mirë. Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie është pasqyruar dhe në udhëzuesit kurrikularë, ku një nga kompetencat që duhet të arrihet nga nxënësit është dhe kompetenca dixhitale. Shkollat e rrjetit S4J që janë të pajisura me klasa të mësimin të kombinuar duhet të planifikojnë që në planin e tyre vjetor për të shfrytëzuar në maksimum potencialin logjistik në dispozicionin tuaj. Praktika të ndjekura deri tani që mjedisi i laboratorit të kombinuar bllokohet vetëm për një klasë të caktuar është keqmenaxhim i burimeve, redukton mundësinë që teknologjia të përdoret për njohuritë apo aftësitë që mund të trajtohen më mirë nëpërmjet saj dhe krijon imazhin e klasave të privileguara në raport me klasat e tjera të shkollës.

Në këtë kontekst, çdo mësues kur dizajnon planin e tij mësimor duhet të marrë parasysh:

- Si mund ta përdor teknologjinë në funksion të të nxënësve?
- A është më e përshtatshme ta përdor në situatat e të nxënësve, në prezantimin e njohurive të reja, në zhvillimin e aftësive profesionale, në vlerësimin e nxënësve, apo përgjatë gjithë mësimin?
- Si mund ta përdor teknologjinë në funksion të zhvillimit të mendimit kritik të nxënësve?
- Sa është e mundur të arrihet kompetenca dixhitale e nxënësve në orë të ndryshme mësimore?

Në këtë mënyrë do të bëhet e mundur që mësimi të zhvillohet në mjedisin e përshtatshëm, të organizohet si duhet orari i shkollës dhe përdorimi i teknologjisë të jetë real.

Veprimtaritë

Përcaktimi i duhur i metodologjisë së mësimdhënies, e bën më të qartë për mësuesin përcaktimin e veprimtarive që do të zhvillojë gjatë një ore mësimore. Në ideimin e veprimtarive mësimore çdo mësues duhet të ketë parasysh sesa mundësi kanë nxënësit për t'u praktikuar me qëllim arritjen e rezultatit mësimor të dëshiruar.

Veprimtaritë mësimore duhet të plotësojnë disa kritere:

1. Kërkesa të larta kognitive:

Veprimtaritë duhet të nxisin të menduar të nivelit të lartë, duke mundësuar që veprimtaritë të kërkojnë më shumë sesa thjesht aftësitë bazë.

2. Të nxënët me bashkëpunim të strukturuar:

Veprimtaritë duhet të nxitin të nxënët nëpërmjet punës dyshe, grupeve të vogla dhe të inkurajojnë nxënësit të shkëmbejnë ide, përmbajtje dhe strategji.

3. Të nxënët aktiv:

Duhet të planifikohen teknika pjesëmarrjeje që edukojnë të menduarit dhe të dëgjuarit.

4. Procedura:

Përshkrimi i procedurave (kalimet dhe rutinat) duhet të planifikohet me qartësi, si do të tërhiqet vëmendja e nxënësve, si do të vëzhgohen e mbështeten nxënësit gjatë punës në grup, në kompjuter apo në mjediset e tjera të të nxënët?

5. Komunikimi:

Përdorimi i përshtatshëm i fjalëve për të shpjeguar konceptet kyçe.

Tre kriteret e para mund të parashikohen që në planin vjetor të lëndës, 4 dhe 5, janë elementë që mësuesi duhet t'i planifikojë në planin e tij ditor.

Vlerësimi

Vlerësimi i pasqyruar në udhëzuesit kurrikularë (sipas terminologjisë së përdorur në udhëzuesit zyrtarë)

1	Lëndët e kulturës së përgjithshme	Vlerësimi
2	Lëndët teorike profesionale	Instrumente vlerësimi
3	Modulet e praktikave profesionale	Instrumentet e vlerësimit

Kompetencat e përgjithshme dhe ato të lëndës që duhet të arrihen nga nxënësi përgjatë procesit mësimor në lëndët e kulturës së përgjithshme, teorisë profesionale dhe moduleve të praktikës, kërkojnë që dhe vlerësimi i nxënësve të jetë i shumëllojshëm dhe në funksion të matjes reale të njohurive, aftësive, shprehive e qëndrimeve të nxënësve.

Duke patur parasysh tri fushat e zhvillimit që përfshijnë kompetencat e përgjithshme dhe ato të lëndës, çdo mësues, në përcaktimin e mënyrës së vlerësimit dhe përzgjedhjes së instrumenteve të duhura, duhet të ketë parasysh se si të përcaktojë instrumente vlerësimi të përshtatshme për tri fushat e të nxënësve:

A përfshin vlerësimi tri fushat?

- Fitimin e njohurive dhe aftësive intelektuale (kognitive);
- Arritjen e qëndrimeve dhe vlerave (afektive); dhe
- Zhvillimin e aftësive muskulare dhe koordinimin (psikomotor).

Për modulet e praktikës profesionale: Krahas vëzhgimit e listave të kontrollit sugjerohet të përdoren dhe: dosja e nxënësve, projekti, skeda vlerësimi për punën në grup, për të cilat mund të jepen udhëzime të mëtejshme nëse mësuesit do t'i aplikojnë në punën e tyre.

Në rastet e planifikimit të projekteve lëndore e ndër-lëndore, plani mësimor duhet të hartohet paraprakisht që në fillim të vitit dhe mënyra e vlerësimit të nxënësve të jetë e mirëkonceptuar nga mësuesi që në ideimin e projektit.

Burime dhe materiale

1	Lëndët e kulturës së përgjithshme	Tekste shkollore të aprovuara nga MASR
2	Lëndët teorike profesionale	Materiale mësimore të sugjeruara nga AKAFKP
3	Modulet e praktikave profesionale	Materiale mësimore të hartuara vetë
Për shkollat profesionale të përfshira në projekt platforma MësoVet		

Për mësuesit e lëndëve të kulturës së përgjithshme, tekstet shkollore janë të miratuara nga MASR dhe pasqyrojnë kërkesat e kurrikulës për AML. Puna paraprake e mësuesit duhet të konsistojë në përzgjedhjen e përmbajtjes më të përshtatshme për nivelin e nxënësve të tyre dhe arritjen e synimeve. Një ndihmesë për këtë është dhe platforma VET, në të cilën mësuesit mund të gjejnë në varësi të lëndës që japin materiale të përshtatshme mësimore të punuara nga kolegët e tyre. Materialet ndihmëse, përdorimi i teknologjisë dhe materialeve, si dhe përcaktimi i mënyrës më të përshtatshme të vlerësimit në AP merr një rëndësi të veçantë, sepse përzgjedhja e këtyre elementëve të planit do të bëjë të mundur që lëndët e kulturës së përgjithshme të shihen në funksion të formimit të përgjithshëm të nxënësit, por pa cënuar qëllimin e AP.

Në lëndët e teorisë profesionale, mësuesit, duke u nisur nga synimet e lëndës, materialet mësimore dhe niveli i nxënësve, duhet të përshtasin dhe të pasurojnë përmbajtjen mësimore të dhënë në materialet zyrtare për klasën e tyre. Edhe në këtë fushë, përzgjedhja e metodave të mësimdhënies, përdorimi i teknologjisë e përzgjedhja e instrumenteve të vlerësimit duhet të jenë në funksion të lehtësimit të të nxënësve.

Për modulet e praktikës profesionale, duke u mbështetur dhe në udhëzimet e AKAFKP, Në *“programin e mësimdhënies së modulit”*, në përputhje me natyrën e modulit profesional, brenda kohëzgjatjes së RM-ve, mund të parashikohen veprimtari mësimore që tregojnë ato ç’ka kryen si

mësuesi i praktikës, ashtu edhe nxënësi (p.sh., rikujtim i aspekteve teorike, përgatitje e vendit të punës, demonstrim i një procesi pune nga instruktori, praktikë e mbikqyrur ose e pavavrur, e një procesi pune nga nxënësit, provim praktik i nxënësve, vizitë mësimore, praktikë shitesë për modulet ose RM-të që nuk janë arritur nga nxënësit e prapambetur, etj). (Udhëzues për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave profesionale, AKAFPK, 2018)

Gjithashtu për modulet e praktikës profesionale sugjerohen:

- Veprimtari mësimore për prezantimin e nxënësve me qëllimin e modulit dhe realitetin e punës në lidhje me këtë profesion, si: vizita në biznes, takim me të ftuar nga biznesi në klasë, veprimtari nga mësuesi për sistemimin dhe vlefshmërinë e njohurive që nxënësit kanë në lidhje me fushën.
- Veprimtari mësimore për të bërë vlerësimin e kompetencave të arritura gjatë një moduli të zhvilluar.

Përmbledhje

Planifikimi i kujdesshëm bën të mundur jo vetëm që nxënësit të mësojnë më mirë dhe shkolla të arrijnë synimet e saj, por mundëson dhe lehtësimin e punës gjithëvjetore për mësuesit. Një planifikim i kujdesshëm bën që mësimi të jetë i harmonizuar dhe mësuesit e nxënësit të jenë në drejtimin e duhur.

Ashtu si një makinë me rrota të pozicionuara siç duhet mund të ecë drejt, udhëzimet e harmonizuara garantojnë që mësuesit dhe nxënësit të mos përfshihen në situata të vështira ose të rrezikshme, duke bërë të mundur dhe arritjet e kompetencave të parashikuara për nxënësit.

Gjatë planifikimit vjetor të lëndës, duhet të merret parasysh dhe mundësia e integritit të lëndëve, jo vetëm për realizimin e projekteve ndërlëndore, por edhe për realizimin e mësimi duke u mbështetur te njohuritë që nxënësit kanë marrë dhe do të marrin në lëndët profesionale.

- Sa është e mundur që lënda që unë jap të integrohet me lëndët profesionale dhe anasjelltas?
- A mund të koordinohen në një projekt ndërkurrikular me bazë shkollë, njohuritë e lëndëve të përgjithshme, lëndëve teorike profesionale dhe moduleve të praktikës?
- A është e mundur të realizohen qëllimet e lëndës nëpërmjet projekteve lëndore dhe ndërlëndore?

Planifikimi vjetor

Detyra dhe përgjegjësi

Shkollat profesionale, bazuar në skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale, hartojnë kurrikulat shkollore, të cilat miratohen nga drejtori i shkollës, pas pëlqimit nga ekipi lëndor përkatës. (DN, Neni 30, pika 2) (shih shtojcat)

Kurrikula shkollore e çdo kualifikimi profesional ka këtë përbërje: a) “Plani mësimor operativ”, i cili hartohet bazuar te “Plani mësimor” që jepet në skeletkurrikulën e kualifikimit profesional

përkatës. b) “Planet e mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale”, të cilat hartohen bazuar në “Programet e përgjithshme të lëndëve profesionale” përkatëse. c) “Planet e mësimdhënies së moduleve praktike profesionale” të cilat hartohen bazuar në “Përshkruesit e moduleve profesionale” përkatëse. (Neni 30 DN. Pika 3)



mësuesi

- koncepton planin vjetor të lëndës
- X ditë para fillimit të shkollës



ekipi lëndor

- jep pëlqimin për planin vjetor të mësuesit
- 15 ditë para fillimit të shkollës



drejtori

- miraton planin vjetor të mësuesit
- 5 ditë para fillimit të procesit mësimor

Në dispozitat normative gjithashtu janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë për Hartimin e projekteve kurrikulare Neni 72 DN, për Planin vjetor të mësuesit Neni 71 DN, dhe Planin ditor të mësuesit Neni 73, DN. (shih shtojcat 2)

Mësuesi

Mësuesi ka rolin kryesor në hartimin e planeve mësimore të lëndës që jep. Për këtë ai duhet të ndjekë procedurat e përmendura më lart. Njohja e mirë e lëndës që ai jep, njohja e nxënësve të cilëve do t’iu japë mësim dhe njohja e kushteve që shkolla ofron, janë baza për një planifikim të mirë, që duhet të realizohet që në muajt e verës, para fillimit të vitit shkollor.

Ekipet lëndore dhe Njësia e Zhvillimit

Para fillimit të vitit shkollor këto dy struktura të institucionit, duhet të organizojnë takime me mësuesit sipas grup lëndëve, me qëllim diskutimin e mënyrës sesi janë konceptuar planet, gjetjen e mundësive për projekte ndërlëndore në bazë shkolle e klase dhe unifikimin e kërkesave dhe rezultateve të pritshme. Kolegjialiteti në këtë moment merr rëndësi parësore. Ky është moment kur diskutimet mbi qëllimet mësimore, metodat që do të përdoren, mënyra e vlerësimit, përdorimi i mjediseve të shkollës (laboratore, IT, etj) të ideohen në bazë të kontekstit, si dhe të përcaktohen drejtimit e zhvillimit të vazhduar profesional të mësuesve.

Drejtoria

Drejtori i shkollës, si titullar juridik i institucionit, ka për detyrë dhe përgjegjësi të tij përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor dhe zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës (LAPU, Neni 54, pika 2. 3) (shtojca 2).

Për këtë, miratimi i planeve mësimore vjetore prej tij, nuk duhet të jetë një proces formal, i cili konsiston vetëm në firmosjen e planeve, por në një proces real dhe të prekshëm, i cili do të shërbejë për harmonizimin e veprimtarive brenda shkollës, hartimin e orareve të shkollës në

funksion të realizimit real të këtyre veprimtarive. Në arsimin profesional kjo përgjegjësi duhet të konsistojë në kombinimin e tri fushave: lëndë të përgjithshme, lëndë teorike profesionale, module profesionale (të cilat përfshijnë dhe praktikën në biznes), gjë që kërkon një organizim dhe planifikim në një aspekt më gjithëpërfshirës dhe largpamës.

Hartimi i matricës për zbërthimin e kompetencave të përgjithshme përgjatë kurrikulës

Për një planifikim të mirë dhe të kujdesshëm të punës gjithëvjetore, me qëllim zbërthimin e kompetencave të përgjithshme e të lëndës në rezultate të prekshme mësimore, duke u mbështetur në skelet kurrikula sygjerohet që mësuesi në planin e tij të paraqesë një matricë si modeli më poshtë.

Hartimi i kësaj matrice që në fillim të viti shkollor, bën të mundur që mësuesi të jetë më i qartë dhe i saktë në përcaktimin e metodologjisë së mësimdhënies (veprimtarive) dhe në përcaktimin e instrumenteve të vlerësimit që do të përdorë.

Lënda/Moduli	Kompetenca të përgjithshme	Aftësi të buta	Mësimi/Çështja / RM
-	- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim dhe me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.		
	- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.		

Aftësitë e buta

Aftësitë e buta janë të rëndësishme për çdo lloj pune. Ato janë aftësi jo teknike, por që lidhen ngushtë me mënyrën e të punuarit të një personi, përfshirë mënyrën si ndërvepron me kolegët, si komunikon me të tjerët, si zgjidh problemet dhe si menaxhon ngarkesën e punës, e shumë të tjera.

Pavarësisht nga lënda që jepni, ju duhet t'i aftësoni nxënësit tuaj të zhvillojnë aftësitë e buta, me qëllim që të përmirësojnë aftësitë e komunikimit, të zgjidhjes së problemeve në grup në mënyrë konstruktive e të menaxhojnë mirë kohën, aftësi të cilat vlerësohen shumë në tregun e punës.

Disa aftësi të buta, për të cilat mund të punohet gjatë orës së mësimin renditen më poshtë:

- Të dëgjuarit
- Të negociuarit
- Komunikimi joverbal
- Të qenit bindës
- Prezantimi
- Të folurit në publik
- Leximi i gjuhës së trupit
- Të treguarit
- Komunikimi verbal
- Komunikimi vizual
- Shkrimi i raporteve dhe propozimeve
- Aftësitë e të shkruarit
- Të menduarit kritik
- Zgjidhja e problemit
- Kreativiteti
- Vendimmarrja

Që mësuesi të realizojë sa më mirë qëllimet e mësimdhënies, krahas planifikimit të mënyrës se si do të punojë për ndërtimin e njohurive e aftësive të reja sipas kurrikulës, duhet të planifikojë dhe aftësitë e buta, të cilat përshtaten më mirë për nxënësit, në varësi të temës/çështjes që do të trajtojë dhe veprimtarive që do të zhvillohen.

Plotësimi i tabelës më sipër ndihmon mësuesin të jetë më i qartë në punën që do të organizojë dhe arritjen e qëllimeve për formimin e kompetencave të përgjithshme të nxënësit, kërkesë kjo e programeve kurrikulare në të tri fushat e AP (lëndë të përgjithshme, lëndë teorike profesionale, module profesionale).

Pjesa III - Modele planesh vjetore e ditore dhe instrumente vlerësimi

Plan i moduleve profesionale

Mbështetur në udhëzimet e ASCAP, AKAFP, si dhe sugjerimet e bëra nga vetë mësuesit, për një plan real e në ndihmë të procesit mësimor, mësuesit e shkollave profesionale duhet të përfshijnë në planet e tyre dhe:

1. Kompetencat e përgjithshme e të lëndës, që janë të pasqyruara në skelet kurrikulat e AP;
2. Të planifikojnë veprimtari që mund të zhvillohen në terren, vizita me të ftuar në klasë në funksion të qëllimit të modulit;
3. Të planifikojnë instrumente vlerësimi të shumëllojshme, dhe jo vetëm listë kontrolli, me qëllim që vlerësimi të jetë real e të përfshijë një gamë më të madhe të matjes së aftësive, qëndrimeve, vlerave e njohurive të nxënësve;
4. Një kolonë për mbajtjen e shënimeve gjatë zhvillimit të modulit (ndryshime në plan, veprimtari të suksesshme ose jo, etj).

Model plani vjetor

Plani vjetor i praktikës profesionale

Shkolla Profesionale: _____

Qyteti: _____

Viti shkollor: 2018-2019

Drejtimi/Profili profesional: _____ **Niveli II, klasa 12**

Mësuesi: _____

Lënda: _____

Orë gjithsej: orët totale të praktikës

Module Numri i moduleve për lëndën

Moduli 1: Emri i modulit

Orë gjithsej: _____

Periudha kohore: (20 shtator- 30 nëntor)

Kompetenca të përgjithshme që do të arrijë nxënësi në fund të modulit:

(Do të shkruhen duke u mbështetur te skelet kurrikuli, duke u mbështetur te përshtatshmëria që kanë me modulën përkatës.)

Nr	Rezultatet mësimore/periudha	Veprimtaritë mësimore	Lloji	Koha/Orë mësimore	Instrumentet e vlerësimit	Vendi	Kërkesa për realizimin	Shënime
1	plotësohen duke u mbështetur në skelet kurrikul	plotësohen duke u mbështetur në skelet kurrikul	T		Në varësi të llojit të veprimtarisë do të shënohen dhe instrumentet e vlerësimit.	B		Kjo kolonë do të shërbejë për të pasqyruar ndryshimet që mund të bëhen në planifikim.
		-	Pp			K		
		-	Vb					

Shkurtime që mund të përdoren:

- T- teori
- b- biznes
- Pp – punë praktike
- k- klasë
- VB- vizitë në biznes

Programi i mësimdhënies së moduleve praktike profesionale

Shkolla Profesionale

Viti shkollor: 2020-2021

Drejtimi: Elektroteknikë, Niveli I i AP

Programi i mësimdhënies i Modulit Profesional: Matja dhe kontrolli në qarqet elektrike dhe elektronike (Kodi M-12-181-18).

Klasa 11 (33 orë mësimore)

Nr	Rezultatet mësimore/Koha	Veprimtaritë mësimore	Orët/Koha	Instrumentet e vlerësimit	Vendi	Kërkesa për realizimin	Shënime
1	RM 1 Nxënësi kontrollon elementet elektrike (6 orë)	Përgatitja e vendit të punës dhe përzgjedhja e aparateve të kontrollit.	1 orë	Vëzhgim me listë kontrolli.	Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronik e.	-Veglat, pajisjet dhe instrumentet e nevojshme për matje elektrike dhe elektronike (pinca, kaçavida, multimetër, lupë, kapse elementesh elektronikë). - Mjetet dhe materialet për realizimin e qarqeve të ndryshme elektrike (rezistenca, kondesator, bobina, drosela, transformator). - Udhëzues, rregullore, katalogë, etj.	
		Leximi i vlerave të parametrave të rezistencave të llojeve të ndryshme dhe kontrolli i gjendjes së tyre.	1 orë				
		Leximi i vlerave të parametrave të kondensatorëve të llojeve të ndryshme dhe kontrolli i gjendjes së tyre.	1 orë				
		Kontrolli i gjendjes së bobinave dhe droselave të llojeve të ndryshme.	1 orë				
		Kontrolli i gjendjes së transformatorëve	1 orë				
		Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik. Vlerësimi i nxënësve	1 orë				
2	RM 2 Nxënësi kontrollon elementet elektronike (9 orë)	Përgatitja e vendit të punës dhe përzgjedhja e aparateve të kontrollit.	1 orë	Vëzhgim me listë kontrolli.	Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronik e.	Veglat, pajisjet dhe instrumentet e nevojshme për matje elektrike dhe elektronike (multimetër, lupë, kapse për mbajtje të elementeve elektronik). - Mjetet dhe materialet për realizimin e qarqeve të ndryshme elektrike (dioda, tranzistor njepolar dhe dypolar). - Udhëzues, rregullore, katalogë, etj.	
		Leximi i të dhënave në trupin e diodës.	1 orë				
		Përcaktimi i këmbëzave të diodës.	1 orë				
		Kontrollimi i gjendjes për punë të diodës.	1 orë				
		Përcaktimi i këmbëzave dhe tipit të tranzistorëve dypolarë.	1 orë				
		Kontrolli i gjendjes për punë të tranzistorëve dypolar.	1 orë				

		Përcaktimi i këmbëzave dhe tipit të tranzistorëve njëpolarë.	1 orë				
		Kontrollimi i gjendjes së tranzistorëve njëpolar	1 orë				
		Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik. Vlerësimi i nxënësve.	1 orë				
3	RM 3 Nxënësi kryen matjen e madhësive elektrike në qarqe elektrike (9 orë)	Përgatitja e vendit të punës dhe përzgjedhja e aparateve për lidhje dhe matje në qarqet elektrike.	1 orë	Vëzhgim me listë kontrolli.	Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronik e	Veglat, pajisjet dhe instrumentet e nevojshme për matje elektrike dhe elektronike (multimeter, ampermeter, voltmeter, ohmmeter, lupe, kapse për mbajtje të elementeve elektronik).	
		Lidhja e aparatit matës të rrymave në qarkun në seri dhe në paralel.	1 orë			- Mjetet dhe materialet për realizimin e qarqeve të ndryshme elektrike (rezistenca, kondensator, bobina, qarqe në seri dhe paralel me këto elemente, dioda, tranzistor).	
		Lidhja e aparatit të matjes së tensioneve në qarkun në seri dhe në paralel.	1 orë			- Udhëzuesat, rregulloret, katalogët etj.	
		Lidhja e aparatit matës të rezistencës dhe të fuqisë elektrike.	1 orë				
		Matja e rrymave dhe e tensioneve në qarkun me rezistenca në seri.	1 orë				
		Matja e rezistencës dhe fuqisë elektrike në qarkun me rezistenca në seri.	1 orë				
		Matja e rrymave dhe e tensioneve në qarkun me rezistenca në paralel.	1 orë				
		Matja e rezistencës dhe fuqisë elektrike në qarkun me rezistenca në paralel.	1 orë				
		Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik. Vlerësimi i nxënësve.	1 orë				
4	RM 4 Nxënësi kryen matjen e madhësive elektrike dhe të	Përgatitja e vendit të punës dhe oshiloskopit për matje dhe përzgjedhja e aparateve matës të rrymës dhe tensionit.	1 orë	Vëzhgim me listë kontrolli.	Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronik e	Veglat, pajisjet dhe instrumentet e nevojshme për matje elektrike dhe elektronike (oshiloskop, multimeter, ampermeter, voltmetër, lupë, kapse për	

parametrave të elementeve në qarqe elektronike (9 orë)	Përzgjedhja e elementeve elektronikë që do të maten.	1 orë			mbajtje të elementeve elektronikë). - Mjetet dhe materialet për realizimin e qarqeve të ndryshme elektrike (rezistenca, kondesator, bobina, qarqe në seri dhe paralel me këto elementë, dioda, tranzistor). - Udhëzues, rregullore, katalogë, etj.
	Lidhja e aparateve matës të madhësive elektrike dhe të parametrave të elementëve në qarqe elektronikë.	1 orë			
	Matja e rrymës me aparate në qarkun elektronik.	1 orë			
	Matja me oshiloskop e vlerave karakteristike të rrymës.	1 orë			
	Matja me aparate e tensionit në qarkun elektronik	1 orë			
	Matja me oshiloskop e tensionit në qarkun elektronik.	1 orë			
	Matja e parametrave L, R dhe C në elementët elektronikë (bobinës, rezistencës dhe kondensatorit).	1 orë			
	Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik. Vlerësimi i nxënësve.	1 orë			

Matrica e kompetencave për modulin: Matja dhe kontrolli në qarqet elektrike dhe elektronike (Kodi M-12-181-18)

Kompetenca	RM
Kompetenca profesionale	
- Të organizojë vendin e punës.	Në të gjitha RM-të
- Të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.	Në të gjitha RM-të
- Të respektojë standardet e profesionit.	Në të gjitha RM-të
- Të respektojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit.	Në të gjitha RM-të
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.	Në të gjitha RM-të
- Të kryejë saktë veprimet kryesore për të dhënë ndihmën e shpejtë.	Në të gjitha RM-të
- Të lexojë skemat e thjeshta elektrike dhe elektronike.	Në të gjitha RM-të
- Të vizatojë skemat e thjeshta elektrike dhe elektronike.	Në të gjitha RM-të

- Të interpretojë dokumentacionin teknik të profesionit.	Në të gjitha RM-të
- Të bëjë përzgjedhjen e materialeve, veglave dhe pajisjeve të punës.	Në të gjitha RM-të
- Të kryejë matje dhe kontrole për veprimtarinë e elektroteknikës.	Në të gjitha RM-të
Kompetenca të përgjithshme	Në të gjitha RM-të
- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.	Në të gjitha RM-të
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.	Në të gjitha RM-të
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.	Në të gjitha RM-të
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.	Në të gjitha RM-të
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.	Në të gjitha RM-të
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.	Në të gjitha RM-të
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.	Në të gjitha RM-të
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.	Në të gjitha RM-të
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.	Në të gjitha RM-të
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.	Në të gjitha RM-të

Planifikimi i teorisë profesionale

Shkolla Profesionale _____

Viti shkollor 2020-2021

Drejtimi: Hoteleri - Turizëm, Niveli I

Mësuesja: _____

Programi i mësimdhënies i Lëndës Teorike Profesionale: “Organizimi i strukturave hoteliere dhe gastronomike” (L-13-442-17)

Klasa 10

108 orë mësimore

Miratoi: _____

Drejtori: _____

Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Organizimi i strukturave hoteliere dhe gastronomike”, klasa 10 - 108 orë

Tema 1	Industria e mikëpritjes	6 orë
Tema 2	Ndërmarrjet hoteliere, funksionet dhe klasifikimi i tyre	12 orë
Tema 3	Ndërtimi strukturor, pajisjet dhe mobilimi i hoteleve	14 orë
Tema 4	Struktura organizative. Funksionet dhe detyrat e personelit në hotele	18 orë
Tema 5	Komunikimi në ndërmarrjet hoteliere	8 orë
Tema 6	Ndërmarrjet gastronomike, funksioni dhe klasifikimi i tyre	12 orë
Tema 7	Struktura të tjera akomoduese	6 orë
Tema 8	Dokumentacioni teknik në ndërmarrjet hoteliere dhe gastronomike	14 orë
Tema 9	Dokumentacioni i punonjësve në ndërmarrjet hoteliere	6 orë
Tema 10	Mbrojtja dhe siguria e klientëve në ndërmarrjet hoteliere	8 orë
Tema 11	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm në industrinë e mikëpritjes	4 orë

- **Synimi i lëndës “Organizimi i strukturave hoteliere dhe gastronomike”, Klasa 10.**
Të kuptojnë mënyrën sesi funksionon industria e mikëpritjes, organizimin dhe strukturën e saj, të shprehura në mënyrë të detajuar në udhëzuesit lëndorë të AKAFP. (mund të vendosim adresën e web).

Programi i mësimdhënies i Lëndës Profesionale: “Organizimi i strukturave hoteliere dhe gastronomike”, (L-13-442-17)

Klasa 10 – 108 orë mësimore

N r	Temat/ Kohëzgjatja	Çështjet	Koha	Objektivat mësimore	Metodat mësimore	Instrumente të vlerësimit	Vendi	Kërkesa për realizim Burime /mjete/mënyra	Shënime
1	Industria e mikpritjes 6 orë	<p>1.Kuptimi i industrisë së mikpritjes.</p> <p>2.Rëndësia ekonomike dhe sociale e industrisë së mikpritjes.</p> <p>3. Industria e mikpritjes, lidhja e saj me turizmin.</p> <p>4. Karakteristikat bazë dhe prirjet e industrisë së mikpritjes në turizëm.</p> <p>5. Evoluimi i industrisë së mikpritjes, si rrjedhojë e nevojave të klientëve.</p> <p>6. Mundësitë për karrierë në industrinë e mikpritjes. (i ftuar në klasë menaxher biznesi nga I.M / I.T)</p>	<p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p>	<p>-Të kuptojnë se ç'është industria së mikpritjes.</p> <p>-Të argumentojë rëndësinë ekonomike dhe sociale të industrisë së mikpritjes.</p> <p>-Të shpjegojë lidhjen e industrisë së mikpritjes dhe asaj të turizmit.</p> <p>-Të dalloje karakteristikat bazë dhe prirjet e industrisë së mikpritjes në turizëm.</p> <p>-Të përshkruaje evoluimin e</p>	<p>Shpjegim</p> <p>Rrjet i diskutimit</p> <p>Prezantim</p> <p>Rrjeti i diskutimit</p> <p>Shpjegim</p> <p>Bashkëbisedim</p>	<p>Pyetje – përgjigje me gojë</p> <p>Detyrë në klasë (Ese)</p> <p>Minitest</p> <p>Detyrë në klasë (Ese)</p>	<p>Klasa e mësimimit të kombinuar</p>	<p>-Laptop</p> <p>-Monitor</p> <p>-Platforma Mësovet.al</p> <p>-Material mësimor ndihmës për lëndën nga AKAFPK</p> <p>-Material mësimor “Bazat e Hotelarisë dhe Turizmit për shkoll.prof maqedoni ”</p> <p>-Materiale të përgatitura PPT</p>	

			1 orë industrisë së mikpritjes, si rrjedhojë e nevojave të klientëve. - Të identifikojë avantazhet e të punuarit në industrinë e mikpritjes.	(I ftuar në klasë) Bashkëbisedim Punë e pavarur	Detyrë në shtëpi (plotësim i fletës së punës për bisedën me të ftuarin në klasë).				(i ftuar në klasë menaxher biznesi nga I.M / I.T)
--	--	--	---	--	--	--	--	--	---

Shënim:

- Ka çështje që janë të përsëritura pasi është planifikuar që 1 orë të trajtohet nga mësuesi dhe në 1 orë nga i ftuari në klasë. Pra, nëse deri më tani e kemi paraqitur një çështje 2 orë, tani është shembull çështja 7 dhe 8 në temën 2 është shkruar dy herë e njëjta çështje, por në orën e 8 të temës 2 është planifikuar i ftuar në klasë për atë çështje.
- Aty ku thuhet: *Detyrë në shtëpi (plotësim i fletës së punës për bisedën me të ftuarin në klasë)*. Është planifikuar të përdoret fleta e punës (bisedë me një profesionist) e rekomanduar së bashku me grupin e instrumentave të vlerësimit nga ju.
- Aty ku thuhet plotësim i fletës së punës është zgjidhje ushtrimesh për temat përkatëse të shkëputura nga banka e pyetjeve për lëndën.
- Gjatë hartimit të planeve paralelisht po punoj me materialet mësimore për secilën çështje për paraqitjen e tyre në platformën Mësovet.al, pra për secilën çështje unë kam menduar që të trajtohet edhe në platformë me anë të prezantimeve në PPT dhe aktivitetve të tjera që kjo platformë ofron.

Programi i mësimdhënies i Lëndës Profesionale: “Organizimi i strukturave hoteliere dhe gastronomike”, (L-13-442-17)

Varianti - mësim në distancë

Klasa 10 – 108 orë mësimore

Nr	Temat/ Kohëzgjatja	Çështjet	Koha	Objektivat mësimore	Metodat mësimore	Instrumente të vlerësimit	Vendi Aktivitete per realizimin e objektivave	Kërkesa për realizim Burime /mjete/mënyra Lloji i platformës për mësimin në distancë	Shënime
1	Industria e mikpritjes 6 orë	<p>1. Kuptimi i industrisë së mikpritjes.</p> <p>2. Rëndësia ekonomike dhe sociale e industrisë së mikpritjes.</p> <p>3. Industria e mikpritjes, lidhja e saj me turizmin.</p> <p>4. Karakteristikat bazë dhe prirjet e industrisë së</p>	<p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p>	<p>-Të përshkruaje kuptimin e industrisë së mikpritjes.</p> <p>-Të argumentoje rëndësinë ekonomike dhe sociale të industrisë së mikpritjes.</p> <p>-Të shpjegoje lidhjen e industrisë së mikpritjes dhe asaj të turizmit.</p>	<p>Shpjegim</p> <p>Rrjet i diskutimit</p> <p>Prezantim</p> <p>Rrjet i diskutimit</p> <p>Shpjegim</p>	<p>Pyetje – përgjigje me gojë</p> <p>Detyrë në klasë (Ese)</p> <p>Minitest</p>	<p>Video regjistrim me shpjegimin e mësimit</p> <p>Lidhje ne zoom / Forum në platformë</p> <p>Hartimi i quiz ne plaformen Mesovet.al</p> <p>Kryerja e detyrave nga</p>	<p>Laptop</p> <p>Zoom</p> <p>Platforma Mësovet.al</p> <p>Material mësimor ndihmës për lëndën nga AKAFPK</p> <p>Material mësimor “Bazat e Hotelierisë dhe Turizmit për shkollat profesionale në Maqedoni”</p>	<p>(i ftuar në klasë menaxher biznesi nga I.M / I.T)</p> <p>Në këtë rast mund të kemi një video mesazh i regjistruar në bazë të disa pyetjeve të parapërgatitura nga mësuesi dhe nxënësit.</p>

		<p>mikpritjes në turizëm.</p> <p>5. Evoluimi i industrisë së mikpritjes, si rrjedhojë e nevojave të klientëve.</p> <p>6. Mundësitë për karrierë në industrinë e mikpritjes (i ftuar në klasë menaxher biznesi nga I.M / I.T)</p>	<p>1 orë</p> <p>1 orë</p>	<p>-Të dalloje karakteristikat bazë dhe prirjet e industrisë së mikpritjes në turizëm.</p> <p>-Të përshkruaje evoluimin e industrisë së mikpritjes, si rrjedhojë e nevojave të klientëve.</p> <p>- Të identifikojë avantazhet e të punuarit në industrinë e mikpritjes</p>	<p>Bashkëbisedim</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Punë e pavarur</p>	<p>Detyrë në klasë (Ese)</p> <p>Detyrë në shtëpi (plotësim i fletës së punës për bisedën me të ftuarin në klasë).</p>	<p>nxenesit dhe hedhja ne platformën e llogarinë e tyre.</p>	<p>Materiale të përgatitura PPT</p>	
2	<p>Ndërmarrjet hoteliere, funksionet dhe klasifikimi i tyre</p> <p>12 orë</p>	<p>1.Karakteristikat e strukturave akomoduese hoteliere.</p> <p>2.Shërbimet e strukturave akomoduese hoteliere.</p> <p>3. Llojet dhe organizimet e strukturave akomoduese.</p> <p>4. Veçoritë e klasifikimit të hoteleve në</p>	<p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p>	<p>- Të listojë karakteristikat e strukturave akomoduese hoteliere.</p> <p>-Të përshkruaje shërbimet e strukturave akomoduese hoteliere.</p> <p>-Të dalloje llojet dhe organizimet e strukturave akomoduese.</p>	<p>Shpjegim</p> <p>Rrjet i diskutimit</p> <p>Punë në grup</p>	<p>Minitest</p> <p>Pyetje – përgjigje me gojë</p> <p>Detyrë në klasë</p> <p>Detyrë në shtëpi</p>		<p>- Material mësimor ndihmës për lëndën nga AKAFPK</p> <p>-Laptop</p> <p>-Video projektor</p> <p>-Platforma Mësovet.al</p> <p>-Materiale të përgatitura PPT</p>	<p>(I ftuar në klasë, ekspert i fushës)</p> <p>Në këtë rast mund të kemi një video mesazh i regjistruar në bazë të disa pyetjeve të parapërgatitura nga mësuesi dhe nxënësit.</p> <p>I ftuar në klasë ekspert i fushës)</p>

		<p>bazë të vendodhjes dhe kapacitetit (madhësisë) të strehimit.</p> <p>5. Veçoritë e klasifikimit të hoteleve në bazë të nivelit të shërbimit që ato ofrojnë dhe sezonit të funksionimit të tyre</p> <p>6. Veçoritë e kategorizimit të hoteleve sipas legjislacionit shqiptar.</p> <p>7. Format dhe llojet më të zhvilluara të ndërmarrjeve hoteliere si dhe karakteristikat e tyre në Shqipëri.</p> <p>8. Format dhe llojet më të zhvilluara të ndërmarrjeve hoteliere si dhe karakteristikat e tyre në</p>	<p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p>	<p>-Të përshkruaje veçoritë e klasifikimit të hoteleve në bazë të vendodhjes.</p> <p>- -Të përshkruaje veçoritë e klasifikimit të hoteleve në bazë të kapacitetit (madhësisë) të strehimit.</p> <p>-Të përshkruaje veçoritë e klasifikimit të në bazë të nivelit të shërbimit që ato ofrojnë.</p> <p>-Të përshkruaje veçoritë e klasifikimit të hoteleve në bazë të sezonit të funksionimit të tyre, pronësisë etj.</p>	<p>Punë e pavarur</p> <p>Prezantim</p> <p>Bashkëbisedim</p>	<p>Detyrë në shtëpi (plotësim i fletës së punës për bisedën me të ftuarin në klasë).</p>			
--	--	--	---	---	---	--	--	--	--

		<p>Shqipëri. (I ftuar në klasë, ekspert i fushës)</p> <p>9. Format dhe llojet më të zhvilluara të ndërmarrjeve gastronomike, si dhe karakteristikat e tyre në Shqipëri.</p> <p>10. Format dhe llojet më të zhvilluara të ndërmarrjeve gastronomike, si dhe karakteristikat e tyre në Shqipëri (I ftuar në klasë ekspert i fushës)</p> <p>11.Përsëritje (tema 1,2)</p> <p>12.Kontroll njohurish/ Detyrë kontrolli (tema 1,2)</p>	<p>1 orë</p> <p>1 orë</p>	<p>-Të dallojnë veçoritë e kategorizimit të hoteleve sipas legjislacionit shqiptar.</p> <p>-Të argumentojnë me shembuj format dhe llojet më të zhvilluara të ndërmarrjeve hoteliere e gastronomike.</p> <p>-Të dallojnë veçoritë e ndërmarrjeve gastronomike në Shqipëri.</p>	<p>Bashkëbisedim</p> <p>Testim</p>	<p>Plotësim i fletës së punës (ushtrime)</p> <p>Pyetje-Përgjigje me shkrim.</p>			
--	--	---	---	---	------------------------------------	---	--	--	--

Shënim:

- Në plan nuk ndryshohet as metoda mesimore as instrumentet e vlerësimit, por në varësi të tyre të mendohen aktivitete dhe platforma që janë efektive që plani të realizohet ashtu siç do të realizohej në kushte normale.

Shembull a) Nëse metoda është shpjegim, mësuesi realizon një videoregjistrim me konceptet kryesore që ka planifikuar të shpjegojë, apo nëse metoda është rrjet diskutimi mund të krijohet një forum për atë çështje për diskutim; b) Nëse instrumenti i vlerësimit është minitest mund të krijohet një quiz në platformë në lidhje objektivat e çështjes.

Plani vjetor mësimor i lëndëve të kulturës së përgjithshme

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE

PLANI MËSIMOR

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi

VITI SHKOLLOR 2020-2021

Lënda: Histori Klasa XI Shkalla V

Mësuesi i Lëndës

Zv/Drejtori

Drejtori

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe (sipas udhëzuesve të ASCAP)

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës/fushës (sipas udhëzuesve të ASCAP)

Matrica e kompetencave për lëndën e historisë 11

Kompetenca kyçe	Tematika
Kompetenca e komunikimit <ul style="list-style-type: none">• zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar njohuritë historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë;• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe të mbiemrave për të përshkuar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.	Shqiptarët në fund të Shek. XIV – fillimi i Shek. XX Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore Shqipëria gjatë regjimit komunist 1945 – 1990 Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë
Kompetenca e të menduarit <ul style="list-style-type: none">- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;	Parahistoria dhe antikiteti në territoret Shqiptare Territoret Shqiptare në mesjetë

<ul style="list-style-type: none"> - zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argument bazuar në burime dhe për të saktësuar burimet; - zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme; - analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshime; - ndërton dhe interpretojnë grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike; - përdor numrat negative dhe pozitive për llogaritjen e kohës. 	<p>Shqiptarët në fund të Shek. XIV – fillimi i Shek. XX</p> <p>Shqipëria dhe shqiptarët 1912 – 1939</p> <p>Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore</p>
<p>Kompetenca e të nxënit</p> <ul style="list-style-type: none"> • përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme dhe i klasifikon ato sipas rëndësisë që kanë për temën; • parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime; • zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet; • ndërlihd temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike; • vlerëson pikëpamjet e ndryshme si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori; • identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe të kompetencave historike në funksion të vetëvlerësimit, të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre. 	<p>Parahistoria dhe antikiteti në territoret Shqiptare</p> <p>Territoret Shqiptare në mesjetë</p> <p>Shqipëria dhe shqiptarët 1912 – 1939</p> <p>Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore</p>
<p>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen e mjedisin</p> <ul style="list-style-type: none"> • harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë; • zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori; • diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe perspektivat e së ardhmes; 	<p>Territoret Shqiptare në mesjetë</p> <p>Shqipëria gjatë regjimit komunist 1945 – 1990</p>

<ul style="list-style-type: none"> bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik, etj.) për realizimin e një veprimtarie të përbashkët. 	
<p>Kompetenca personale</p> <ul style="list-style-type: none"> kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave. përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar idetë e tij. 	<p>Territoret Shqiptare në mesjetë</p> <p>Shqipëria dhe shqiptarët 1912 – 1939</p> <p>Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore</p>
<p>Kompetenca qytetare</p> <ul style="list-style-type: none"> zhvillon kompetencën qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën, që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe e standardeve të ndryshme; shqyrton burimet historike për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet që kanë ndikuar në shoqëri dhe grupe të ndryshme kulturore në kohëra të ndryshme, si dhe shpjegon natyrën, shkaqet dhe pasojat e konflikteve nën varësinë kulturore; kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme; identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tija; shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore; zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme; kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të të tjerëve; shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore; shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik. 	<p>Territoret Shqiptare në mesjetë</p> <p>Shqiptarët në fund të Shek. XIV – fillimi i Shek. XX</p> <p>Shqipëria dhe shqiptarët 1912 – 1939</p> <p>Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore</p> <p>Shqipëria gjatë regjimit komunist 1945 – 1990</p>
<ul style="list-style-type: none"> Kompetenca digjitale 	

<ul style="list-style-type: none"> • zhvillon kompetenca digjitale për të gjetur, për të analizuar, për të komunikuar informacionin historik; • shfrytëzon një sërë burimesh dixhitale të informacionit dhe i analizon në mënyrë kritike këto burime historike; • komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë; • bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar njohuritë historike. 	<p>Shqiptarët në fund të Shek. XIV – fillimi i Shek. XX</p> <p>Shqipëria dhe shqiptarët 1912 – 1939</p> <p>Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore</p> <p>Shqipëria gjatë regjimit komunist 1945 – 1990</p> <p>Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë</p>
--	--

Koha mësimore për çdo tematikë në klasën e njëmbëdhjetë

KLASA 11		
NR.	PROCESET HISTORIKE, KOHA, NDRYSHIMI DHE VAZHDIMËSIA	68
1.	Parahistoria dhe antikiteti në territoret Shqiptare	10
2.	Territoret Shqiptare në mesjetë	6
3.	Shqiptarët në fund të Shek. XIV – fillimi i Shek. XX	12
4.	Shqipëria dhe shqiptarët 1912 – 1939	9
5.	Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore	6
6.	Shqipëria gjatë regjimit komunist 1945 – 1990	10
7.	Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë	6
8.	Projekt	3
9.	Detyra portofoli	3
10.	Test përmbledhës	3

Tematika	Nr	Tema	Koncepte kyçe	Rezultatet e të nxënit	Situatë e të nxënit	Metodologjia	Vlerësimi	Burime	Shënime
Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare 10 orë	1	Gjurmët e parahistorisë në territoret shqiptare	Parahistoria; paleolit; matriarkat; patriarkat; jetë stacionare; homo-sapiens (njeriu i ditur); etnogjenezë; pellazgë; popullësi parailire; fise ilire; troje të fiseve ilire; bujqësi sedentare;blegtori sezonale artizanat familjar i specializuar; shteti parë ilir; luftërat iliro-romake; kuptimi i emrit Epir; aleanca epirote; mbretëria dardane; provincat e Ilirisë së jugut	-shpjegon konceptet: parahistori, histori, paleolit, neolit, eneolit dhe hekur; -vlerëson rolin e mjedisit në zhvillimin e qytetërimeve antike; -përcakton kohën dhe rrethanat e lindjes së qytetërimit antik në territoret shqiptare; - përcakton në hartë vendndodhjen e qytetërimeve antike shqiptare. - përcakton në hartë shtrirjen e fiseve ilire; -liston disa nga emrat më të shquar të fiseve ilire;	Popullsia e të parëve tanë është formuar në territoret e Ballkanit Perëndimor në periudhën e paleolitit të vjetër, pra me periudhën e akullnajave (fq 6)	Diagram piramidal Harta e konceptit Rishikim në dyshe	Vlerësim diagnostikues		Njoh nxënësit me programin mësimor të histori 11

				<p>-dallon elemente të jetës së përditshme në qytetërimet ilire.</p> <p>-shpjegon tiparet e organizimit shoqëror të kolonive greke në trevat ilire;</p> <p>-dallon elemente të jetës së përditshme të kolonive greke në trevat ilire;</p> <p>-përshkruan tiparet e artit dhe kulturës së qytetërimit antik grek në kolonitë e saj.</p> <p>- nxjerr tiparet politike dhe ushtarake të Pirros;</p> <p>- diskuton rreth burimeve të shkruara</p>					
--	--	--	--	---	--	--	--	--	--

				greke dhe romake për pellazgët dhe ilirët; - krahason informacionet e shkruara greke dhe romake - shpjegon faktorët që kushtëzuan përfshirjen e Ilirisë nën Perandorinë Bizantine.					
	2	Ilirët, prejardhja dhe shtrirja e tyre			Në territoret e Ilirisë antike sot shtrihen nëntë shtete: Sllovenia, Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Kroacia, Mali i Zi, Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Greqia. Në këto territore fliten tre gjuhë (shqipja, greqishtja, sllavishtja). Gjuhëtarët provojnë se vetëm shqipja lidhet me gjuhën	Rrjeti i diskutimit Ditari dypjesësh Diagrami piramida	Vlerësimi i vazhduar	Teksti; interneti; Aristidh Kola "Arvanitët" Vështrim historik- folklorik- gjuhësor	

					e lashtë, ilirishten. Ky fakt dhe të tjera tregojnë se shqiptarët janë populli më i vjetër i Ballkanit, pasardhës të ilirëve (fq.10).				
	3	Organizimi ekonomik dhe shoqëror i ilirëve			Shoqëria Ilire u zhvillua mjaftë gjate periudhes se hekurit. U zhvillua bujqësia sedentare, blegtoria sezonale, artizanati, tregtia dhe kembimi. Ilirët kishin gjuhën e tyre, ilirishten, që ishte gjuhë indoeuropiane. Besimi i tyre ishte pagan (politeist) (fq.13).	Parashikim me terma paraprakë Harta e mendjes Rrjeti i diskutimit	Vetëvlerësim		
	4	Shteti i parë ilir			Shteti i parë Ilir lindi në territoret e Ilirisë së Mirëfilltë, rreth shek.V pr.K dhe jetoi gati 300 vjet. Brenda ketij sheti linden tri	Stuhi mendimesh Ditar dypjesësh Rrjeti i diskutimit	Vlerësim individual dhe në grup	Informacion për gjurmët i fiseve ilire në territorin e qarkut të Vlorës;Luftrat Iliro-Romake	Ftojmë në klasë një historian nga UV

					mbreteri: Mbreteria e Enkelejtëve (shek V-335 pr.K); Mbreteria e Taulanteve 9335-231 P.K dhe Mbreteria Ardiane (229-167 pr.K) fq.16				
	5	Shteti i Epirit			Epiri, si njësi e veçantë gjeografike-politike është përmendur që në antikitet. Shtrihej nga mallet Akrokerune dhe rrjedhe e mesme e lumit Vjosa në very deri në gjirin e Ambrakisë në jug, nga mallet e Pindit në Lindje, deri në detin Jon. Në Epir jetonin 14 fise si: molosët, tesprotëte kaonët. Shteti i Epirit u formua në shek. V pr.K. Jetoj tre shekuj dhe kaloi nëpër tri faza fq. 19	Parashikim me terma paraprakë Kllaster Rrjeta e merimangës		Harta e Ilirisë së Jugut; ëikipedia për Pirron e Epirit;Luftrat e pirros me Maqedonasit	
	6	Mbretëria Dardane			Bërthama e Dardanisë antike	Stuhi mendimesh	Vlerësim i vazhduar	Wikipedia për dardanët	

					ka qënë territori i sotëm i Kosovës, i Maqedonisë Veriperëndimore, i Serbisë Jugore, fq.22.	Ditar dypjesësh Diskutim			
	7	Iliria nën Perandorinë Romake	Kërkim shkencor në histori		Pas pushtimit romak, shek I pas Krishtit, Iliria iu nenshtrua strukture administrative të shtetit romak. Zonat e thella ruajtën një autonomi të brendshme. Gjatë shek.III pas Krishtit jeta qytetare lulëzoi. U ndërtuan rrugë transballkanike, u zhvillua tregtia e brendshme dhe ajo e jashtme si dhe degë të ndryshme të zejtarisë, fq.25.	Parashikim me terma paraprakë Harta e mendjes Rrjeti i diskutimit	Vlerësim në grup	Harta administrative e Ilirisë nën perandorinë romake	Përcaktojmë temat që do të kemi për detyrë portofoli
	8	Veprimtari praktike Burimet e shkruara greke e romake për pellazgët dhe Ilirinë			Nxëniesit do të udhëzohen për mënyrën e organizimit të veprimtarisë duke specifikuar detyrat sipas çështjeve që do trajtohen e	Punë në grup Diskutim	Vlerësim i ndërmjetëm	Shyqyri Hysi , për pellazgët dhe ilirët; Straboni dhe Ptolemeu për Pellazgët dhe Ilirët	

					ndërthurur kjo me metodën e hulumtimit, krijim dhe diskutim, fq.28. Lexohen dhe komentohen pjesë të materialit burimor që kanë sjell nxënësit.				
	9	Përsëritje: Antikiteti në territoret shqiptare	Ekskursion mësimor			Punë e pavarur			
	10	Ekskursion historik: Vizitë në qytetin antik të Orikumit ose Aulonës pranë monumentit të Pavarësisë							Ekskursioni do të filmohet ndoshta edhe nga ndonjë nga tv lokale

Planifikimi i projekteve ndërlëndore

Neni 72 i DN përcakton mënyrën e planifikimit, zhvillimit dhe dokumentimit të projektit lëndor dhe ndërlëndor, por në praktikë realizimi i projekteve kërkon një bashkëpunim të mësuesve me njëri tjetrin dhe një organizimin të orareve ndryshe nga mësimi i zakonshëm. Secili mësues në momentin që fillon planifikon për mësimin e tij vjetor, duhet të bashkëpunojë me mësuesit e tjerë për të evidentuar përshtatshëmrinë e tematikës dhe synimeve të projektit me synimet dhe konceptet e lëndës. Më poshtë jepet një model planifikimi për punën me projekte.

Planifikimi i punës me projekte

Titulli: (të jetë i tillë që të angazhojë nxënësit)		Kohëzgjatja totale (në orë)	
Lënda/fusha	Mësues:	Klasa	
Lëndë të tjera mësimore që përfshihen në projekt (nëse ka):			
Kompetencat kyçe Cilat kompetenca do të jenë në fokus?			
Lënda	Idea (idetë)	Kompetenca kurrikulare	Përmbajtja kurrikulare
Vlerësimi			

Rubrikat/veprimtaritë e vlerësimit	Lidhja kurrikulare	Formues apo përmbledhës?	Individual apo në grup?
Skenari Real apo imagjinar?		Sfida Një përshkrim i detyrave që do t'i prezantohen nxënësve	
Pyetja drejtuese e projektit			
<p>Për mësuesit: Një pyetje që ndihon për të filluar dhe për t'u fokusuar në kërkim</p> <p>Për nxënësit: Një pyetje që krijon interes dhe ndjenjën e sfidës dhe i udhëheq në punën gjatë projektit.</p>			
Ngjarja hyrëse (prezantimi)			
Produktet			
Audiençë publike			

(ekspertë. Përdorues produkti, që do të angazhohen gjatë dhe në fund të projektit)	
Njohuri dhe aftësi që duhet të ketë për të realizuar projektin	
Burime dhe materiale që nevojiten	
Dizenjim universal për të nxënësit- strategji dhe mjete për mësimdhënien e të nxënësit	
Kuptime të ndryshme të prezantimit Metodologjia që do të përdoret	
Mjete të ndryshme të shprehurit Si do ta demnistrojnë nxënësit të nxënësit e tyre	
Mënyra të ndryshme të angazhimit Çfarë do t'i ndihmojë nxënësit të rritin interesin për të nxënësit e tyre?	
Metoda reflektimi Si individ, grupi dhe e gjithë klasa do të reflektojnë gjatë dhe në fund të projektit?	

Plani i mësimit PBL

Ideja e projektit		
Përmbajtja kurrikulare	Kompetenca kurrikulare	Kompetenca kyçe
Këtu do të shkruhen temat mësimore që përfshihen në këtë projekt	Këtu do të shkruhen kompetencat që synohen përtej atyre të lëndës	Këtu do të shkruhen kompetencat kyçe synohen për lëndën/lëndët e përfshira

Qëllimi/ pritsmëritë <i>Cili është qëllimi që dua të arrij? Si do të di që nxënësit i kanë arritur këto qëllime?</i>		
K/G/I	Agazhimi i nxënësve	
	Këtu do të shkruhet se si do të angazhohen nxënësit gjatë punës (gjithë klasa, grupe, dyshe) në lidhje me punën që do të bëjnë	
	Veprimtaritë e planit mësimor	
	Këtu do të përshkruhen të gjitha veprimtaritë në lidhje me realizimin e idesë së projektit	
Për gjithë klasën/	Detyra	
	Detyra për hulumtim, punë në grupe, prezantim, realizim produkti	

	Afati
	Shtrirja në kohë.

Plani ditor - udhëzime

Planifikimi i kujdesshëm të orës së mësimi është një domosdoshmëri për një mësimdhënie efektive për t'iu përshtatur sa më mirë interesave të klasës dhe arritjeve të objektivave të kurrikulës. Një mësues që ka planifikuar në mënyrë të kujdesshme e të mirëmenduar planin mësimor vjetor për lëndën e tij dhe është i qartë për atë që ai dëshiron që nxënësi të dijë, të kuptojë, ose të jetë i aftë për të bërë pas mbarimit të një teme (kapitulli), si dhe ka përcaktuar mënyrat e vlerësimit, është shumë e lehtë të përgatitja e planit ditor (ditarit).

Planifikimi i orës së mësimi e bën mësimin më të strukturuar, të organizuar dhe i rendit çështjet sipas një radhe të caktuar dhe garanton kohën optimale për veprimtaritë e detyrat që zhvillohen në klasë.

Vendimet që mësuesi merr për planifikimin.

Katër vendime të rëndësishme:

- nevoja për të adresuar përmbajtjen dhe metodologjinë në etapat ose standardet e dhëna në udhëzimet kurrikulare shtetërore.
- marrjen e vendimeve rreth mënyrave për të ilustruar ose demonstruar konceptin/et që do të trajtohen, për nxënësit (demonstrim, video, tekst dhe ekskurSION).
- vazhdimësia.
- lidhjes së mësimi me njohuritë e marra më herët nga nxënësit.

Marrja e këtyre vendimeve një gjykim profesionist dhe përfshin konsideratat filozofike rreth vlerës së qëllimeve e objektivave të ndryshme.

Mësuesit duhet të fokusohen në nëndarjen e informacionit “të ditur”, i konsideruar të jetë i nevojshëm dhe i dëshirueshëm.

Mbjaj mend! Edukimi nuk është një zotërim i një numri të gjerë dijesh të dëshirueshme (intelektuale dhe morale), por gjithashtu dhe aftësi për të manifestuar ose vënë në punë këto njohuri.

Standardet kombëtare (të paraqitura në udhëzuesit kurrikulare), ndikojnë në kurrikulumin e shkollës, prandaj në hartimin e materialeve mësimore mësuesi paraprakisht:

- Përzgjedh rezultatin që duhet zotëruar dhe burimet e informacionit, dhe:
- Unifikon këto rezultate në lidhje me temën/çështjen (që do të trajtohet), duke marrë parasysh, sasia e informacionit në përputhje me moshën e nivelin e nxënësve, mënyra sesi jepen, faktet, abstraksionet e konceptet, sa kuptimplotë është informacioni, njohuria, etj.
- Harton pyetjet kryesore dhe zhvillon mbështetjen e pyetjeve.
- Përcakton performancën e pranuar për nxënësit.
- Përzgjedh veprimtaritë që do ta çojnë nxënësin drejt zotërimit - metodologjia që përdoret në klasë.
- Zhvillon rubrika për të vlerësuar performancën- vlerësimi.
- Rishikon planin që çdo komponent i mësimit të mbështesë tjetrin.

Pavarësisht formateve që ofrohen dhe qasjes me të cilën punohet, plani ditor duhet të ketë të pasqyruara qartë:

1. Objektivat mësimore që duhet të arrihen.
 2. Veprimtaritë mësimore (hyrëse, zhvilluese e përmbyllëse) dhe përcaktimin e kohës për secilën veprimtari.
 3. Mënyrën e vlerësimit të nxënësve.
- Të tre këta elementë të jenë të harmonizuara dhe të përputhen me njëra tjetrën.

Plani ditor - Formate

1. Plan ditor për lëndë të përgjithshme

Fusha: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla: V

Klasa: XIII

Tematika: Diversiteti

Tema mësimore: Ndikimi i njeriut në mjedis: Ndotja.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore

Nxënësi:

- përshkruan se si mund ta transformojë njeriu mjedisin e vet;
- shpjegon se ndryshimet që ka pësuar shoqëria njerëzore janë shoqëruar me ndryshimin e ndikimit në mjedis;
- analizon pasojat e ndikimit të njeriut në mjedis.

Fjalë kyçe: Ndotja, Shpyllëzimi, Shkretëtirëzim, Efekti serë, Lëndë të degradueshme dhe të padegradueshme, Pesticide.

Zhvillimi i mësimit:

Situata e të nxënësve:

U shfaqet nxënësve një video mësimore (5 minuta) mbi mjedisin dhe ndikimin e njeriut në të.

Diskutim me nxënësit: Cilat janë pasojat negative të ndikimit të njeriut në mjedis? Cilat janë zgjidhjet?

Ndërtimi i njohurive.

Punojnë nxënësit në dyshe për plotësimin e tabelës DDM “Ndikimi I njeriut mbi mjedisin”

Di/Se njeriu ndikon pozitivisht dhe negativisht me veprimtarinë e tij në mjedis.

Dua të di/

- Çfarë pasojash negative ka ndotja e atmosferës?
- Cila është pasoja e rritjes së efektit serë?
- Cilat janë dëmet që shkakton shiu acid?
- Cilët janë efektet negative të lëndëve të padegradueshme?

Mësova

1. Nga ndotja e atmosferës së tokës ka dy probleme madhore:

- efekti serë;
- formimi i shiut acid.

2. Pasoja e rritjes së efektit serë është ngrohja globale.

3. Dëmet që shkakton shiu acid janë;

toka bëhet acide, mineralet që shpëlahen shkojnë në lumenj e liqene dhe shkaktojnë ngordhjen e gjallesave, zinxhirët ushqimorë pësojnë dëmtime, drurët e pyjeve vuajnë mungesën e mineraleve.

4. Lëndët e padegradueshme kanë disa efekte negative. Ato:

- bllokojnë kalimin e ujit në kanalet e drenazhimit;
- mund të konsumohen gabimisht nga kafshët dhe të bllokojnë sistemin e tyre tretës;
- pengojnë dekompozimin e mbetjejeve etj.

Përforcimi i njohurive: Diskutim i drejtuar

Nxënësi:

- tregon si ndikon negativisht përdorimi i DDT në një zinxhir ushqimor;
- analizon pasojat negative të përdorimit të pesticideve DDT në një mjedis;
- përshkruan disa nga masat që mund të merren për të zgjidhur problemet e shkaktuara nga DDT.

Vlerësimi: kuic me 5 pyetje mbi njohuritë e marra: efekti serrë, ngrohja globale, shiu acid

Detyrë: Ushtrimin 1, në librin e nxënësit, në faqe 108.

2. Plan ditor: Lëndë teorike profesionale

Lënda: Organizimi i Strukturave Hoteliere dhe Gastronomike

Tema: Industria e mikpritjes, lidhja e saj me turizmin

Objektivat e orës mësimore: Në fund të orës mësimore nxënësi/ja duhet të jetë i/e aftë:

1. Të përshkruajë lidhjen e industrisë së mikpritjes me turizmin.
2. Të identifikojë karakteristikat që e veçojnë industrinë e mikpritjes nga industritë e tjera.
3. Të shpjegojë varësinë reciproke të industrisë së turizmit me industrinë e mikpritjes.

Metoda

1	P	Parashikimi	Diskutim i njohurive paraprake
2	N	Ndërtimi i njohurive	INSERT
3	P	Përforcimi	Rrjet i diskutimit

Mjete/Burime informacioni: Laptop, monitor, video-projektor/ Material i përpunuar (leksione të grumbulluara "**Bazat e Hotelerisë dhe Turizmit për shkollën profesionale Maqedoni**") /materiale në PPT, material audioviziv dhe kuic në platformën Mësovet.al.

Plani i orës mësimore:

Faza 1 (7 minuta)

Prezantim i temës dhe objektivave të orës mësimore.

Prezantim (video me karakteristikat e I.M) **(2 min)**

Diskutim i njohurive të përvetësuara mbi industrinë e mikpritjes dhe orientim i nxënësve për pjesët që do lexojnë. **(5 minuta)**

Faza 2 (25 minuta)

Nxënësit lexojnë mësimin për disa minuta (sipas teknikes insert). **(10 minuta)**

Nxënësit identifikojne informacionin e njohur, informacionin e ri dhe ndonjë paqartësi që mund të kenë gjatë leximit. **(15 minuta)**

Faza 3 (13 minuta)

Diskutim (i orientuar në arritjen e objektivave) mbi lidhjen që ka I.M me I.T si dhe varesia reciproke që ata kanë, karakteristikat e seciles prej tyre etj. **(6 minuta)**

Pyetje dhe paqartësi (nëse ka) nga ana e nxënësve. **(2 minuta)**

Minitest: Listo karakteristikat e industrisë së mikpritjes. **(5 minuta)**

Vlerësim: Pyetje - përgjigje me gojë, Minitest

Shënim:

Në fazën e dytë pjesa e dytë 15 minuta është nga 5 minuta për identifikimin e 3 grup informacionesh sipas teknikës së mësimdhënies. Në fazën e 3 aty ku është diskutim i orientuar në objektivat e orës mësimore janë 6 minuta, nga 2 minuta për secilin objektiv.


Me këtë plan ditor për këtë çështje ora mësimore mund të realizohet me sukses edhe në një klasë standarde, edhe në klasën e mësimin të kombinuar, pasi mjetet dhe burimet janë planifikuar për të dyja mundësitë.

3. Plan ditor: Module profesionale

Klasa: 11

Moduli: Realizimi i skemave elektronike me qark të integruar M-12-1437-18.

RM4: Nxënësi vë në funksionim skemën të gjeneratorit me qark të integruar.



Veprimtaria: Lidhja e skemës së gjeneratorit me burimin e ushqimit 2 orë mësimore (60 minuta).

Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të lidhë siç duhet skemën e gjeneratorit me burimin e ushqimit.

Mjetet e punës: Skema për çdo nxënës, timer 555, qark i integruar 4017, rezistenca, kondensator, me vlerat të ndryshme sipas kërkesës së skemës, dioda, bateri 9V, lastra, breadboard etj.

Realizimi i veprimtarisë mësimore:

Pas shpërndarjes së skemës, nxënësve iu demonstron lidhja e skemës në një breadboard.

Kohëzgjatja (10 min)Nxënësit vizatojnë skemën në lastër për ta patur më të lehtë procesin e lidhjes së skemës. Kohëzgjatja (10 min).



Nxënësit krijojnë qarkun në lastër sipas skemës së dhënë, në mënyrë të pavarur duke u vëzhguar me listë kontrolli. Kohëzgjatja (30 min)

Punët vendosen në stendë dhe nxënësit vlerësojnë punën më të bukur. Kohëzgjatja (30 min)

Vlerësimi i nxënësit: Vlerësim me listë kontrolli

4. Plani individual i punës në biznes

Moduli: _____

Emri i praktikantit: _____

Periudha e Praktikës _____

Vendi i Praktikës/Kompania: _____

Instruktori përgjegjës në biznes: _____

Qëllimi: Të aftësohen nxënësit për të kryer parapërgatitjen dhe gatimin e asortimenteve me mish

Kompetenca të përgjithshme:

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.

– Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.

Vendi i punës	RM	vlerësimi				
		1	2	3	4	5
Kuzhina e restorantit	Nxënësi identifikon pjesët e mishit sipas ndarjes anatomike të tij.					
	Nxënësi zbaton teknikat e përpunimit të mishrave, sipas pjesëve dhe recetës.					
	Nxënësi përgatit buljone me mish/shpendë.					
	Nxënësi përgatit gatime me mish/shpendë, me salca shoqëruese.					
	Nxënësi përgatit supra.					
	Nxënësi përgatit gatime me mish/shpendë, me garniture.					
	Nxënësi përgatit gatime tradicionale me mish/shpendë					
Shënime të instruktorit	<i>Këtu do të shkruhet një vlerësim me shprehje për realizimin e kompetencave të përgjithshme.</i>					

Instrumente vlerësimi për planifikimin

Listë kontrolli për vlerësimin e planifikimit në lëndët e formimit të përgjithshëm
(Shembull i marrë nga Selman Feraj Shkolla Industriale “Pavarësia” Vlorë)

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME
Shkolla:
Lënda:
Mësuesi/ja
Vlerësuesi/ja
Datë:

1.Plani mësimor është hartuar në përputhje me kurrikulën e re .	Po	Jo	Komente
1.1 Plani mësimor është në përputhje me kornizën kurrikulare			
1.2 Plani mësimor është në përputhje me kurrikulën bërthamë			
1.3 Plani mësimor është në përputhje me programin mësimor			
1.4 Plani mësimor ka strukturë të detajuar sipas kërkesave të kurrikulës sipas drejtimeve që ka shkolla			
1.5 Mësuesi ka realizuar planifikimin vjetor të lëndës			
1.6 Mësuesi ka përcaktuar saktë tematikën			
1.7 Mësuesi ka planifikuar shpërndarjen e përmbajtje lëndore sipas periudhave			
1.8 Mësuesi ka përcaktuar orët mësimore për secilën periudhë			
1.9 Mësuesi ka planifikuar në përputhje me tekstin e përzgjedhur			
1.10 Mësuesi ka planifikuar burime alternative për realizimin e planit mësimor			
1.11 Në planin mësimor mësuesi ka vendosur rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe			
1.12 Në planin mësimor mësuesi ka vendosur rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës			
1.13 Në planin mësimor është vendosur numri rendor për temat mësimore			
1.14 Numri rendor përkon me numrin e orëve të përcaktuara në planin vjetor			
1.15 Tematika përputhet me temat e planifikuara			
1.16 Temat mësimore janë renditur sipas planifikimit vjetor			
1.17 Mësuesi ka përcaktuar situatën e të nxënit në përputhje me përmbajtjen e temës mësimore			
1.18 Metodat e përzgjedhura janë në funksion të temës mësimore			
1.19 Mësuesi ka përcaktuar teknikat e vlerësimit që do përdoren			
1.20 Në planin mësimor janë përcaktuar burimet që do përdoren për arritjen e rezultateve të të nxënit			
1.21 Mësuesi ka planifikuar si burim përdorimin e infrastrukturës së shkollës (infotekë, klasa të mësimi të kombinuar)			
1.22 Mësuesi shkruan planin mësimor me të njëjtin lloj shkrimi			
1.23 Mësuesi ka përdorur të 36 shkronjat e alfabetit			
1.24 Mësuesi ka përdorur format standart për planin			
1.25 Mësuesi ka respektuar me korrektësi normat e drejtshkrimit			

1.26 Plani ka kulturë shkrimi dhe origjinalitet			
1.27 Plani mësimor është miratuar nga drejtorja e shkollës (firmë e vulë të institucionit)			

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	
Shkolla/Qyteti:	
Moduli:	
Kodi i modulit:	
Mësuesi/ja:	
Vlerësuesi/ja:	Datë:

Listë kontrolli për vlerësimin e programeve të mësimdhënies të moduleve profesionale

1. Programet mësimore hartohet në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulit të drejtimit/profilin profesional dhe udhëzuesve të AKAFPK mbështetur në DN.			
Kriteret e vlerësimit:	Po	Jo	Shënime
1.1 A është hartuar programi i mësimdhënies së modulit në përputhje me përshkruesin e modulit profesional përkatës, të pasqyruara te Skeletkurrikuli i drejtimit/profilin profesional?			
1.2. A është ruajtur në programin e mësimdhënies së modulit sasia e orëve të dhëna në Skeletkurrikul?			
1.3. A është vendosur saktë në programin e mësimdhënies së modulit emërtimi i modulit?			
1.4 A është vendosur saktë në programin e mësimdhënies së modulit profesional kodi i modulit?			
1.5 A është vendosur saktë në programin e mësimdhënies së modulit profesional drejtimit/profilin?			
1.6 A është vendosur saktë në programin e mësimdhënies së modulit profesional niveli i kualifikimit profesional?			
1.7 A është vendosur saktë në programin e mësimdhënies së modulit profesional viti shkollor?			
1.8 A është vendosur në programin e mësimdhënies së modulit profesional klasa?			
1.9 A është vendosur në programin e mësimdhënies së modulit profesional emri i mësuesit/es.			
1.10 A është hartuar programi i mësimdhënies i modulit praktik profesional duke u mbështetur në formate të rekomanduara nga institucioni shtetëror (AKAFPK) që harton Skeletkurrikulat e drejtimeve/profileve profesionale?			
1.11 A ruan programi i mësimdhënies së modulit praktik profesional të njëjtat rezultate mësimore (RM), instrumente dhe kriteret vlerësimi, ashtu siç dhe paraqiten te përshkruesit e moduleve të Skeletkurrikulit të drejtimit/profilin profesional?			

1. Programet mësimore hartohet në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulit të drejtimit/profilit profesional dhe udhëzuesve të AKAFPK mbështetur në DN.			
1.12 A është hartuar programi i mësimdhënies i modulit praktik profesional në përputhje me natyrën e modulit dhe brenda kohëzgjatjes së RM-së janë planifikuar veprimtari mësimore si për mësuesin/instruktorin ashtu dhe për nxënësin/en, të cilat lidhen kryesisht me veprimtari të natyrës praktike?			
1.13 A janë planifikuar veprimtaritë mësimore jo më pak se 1 dhe jo më shumë se 3 orë mësimore?			
1.14 A janë planifikuar në programin e mësimdhënies së modulit praktik profesional për çdo veprimtari mësimore 1-3 orë mësimore për vlerësimin e nxënësve, sasi e cila caktohet nga gjykimi profesional i anëtarëve të ekipit?			
1.15 A është planifikuar në programet e mësimdhënies së modulit praktik profesional për çdo RM, jo më pak se 3 orë mësimore?			
1.16 A është përcaktuar mjedisi ku do të zhvillohet veprimtaria mësimore?			
1.17 A janë përcaktuar në programin e mësimdhënies së modulit praktik profesional orë për vizita mësimore?			
1.18 A janë përcaktuar në programin e mësimdhënies së modulit praktik profesional rubrika RM/kohëzgjatja?			

2. Kërkesat për realizim			
Kriteret e vlerësimit:	Po	Jo	Shënime
2.1 A janë planifikuar në programin e mësimdhënies së modulit praktik profesional materiale burimore për realizimin e modulit?			
2.2 A është planifikuar në programin e mësimdhënies së modulit praktik profesional përdorimi i pajisjeve digjitale, sipas mundësive të IoAFP-së?			

3. Të tjera			
Kriteret e vlerësimit:	Po	Jo	Shënime
3.1 A rezultojnë në programin e mësimdhënies së modulit praktik profesional, gabime drejtshkrimore?			
3.2 A është punuar me formatet e kërkuara për një dokument, si: tipi i shkrimit, madhësia etj?			
3.3 A përdoren shkronjat 'ë' dhe 'ç'?			

Komente të përgjithshme

Listë kontrolli për vlerësimin e programeve mësimore në lëndët e teorisë profesionale

Kodi			
	1. Programet mësimore hartohet në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulit të drejtimit/profililit profesional dhe udhëzuesve të AKAFPK mbështetur në DN.		
	Kritere vlerësimi:	Po	Jo
			Shënime
1	Programi mësimor është hartuar në përputhje me programet e përgjithshme të lëndës profesionale përkatëse, të pasqyruara te Skeletkurrikuli i drejtimit/profililit profesional.		
2	Në programin e mësimor është ruajtur sasia e orëve të dhëna në Skeletkurrikul.		
3	Në programin mësimor është vendosur emërtimi i lëndës.		
4	Në programin mësimor është vendosur kodi.		
5	Në programin mësimor është vendosur drejtimi/profili.		
6	Në programin mësimor është vendosur niveli.		
7	Në programin mësimor është vendosur viti shkollor.		
8	Në programin mësimor është vendosur klasa.		
9	Në programin mësimor është vendosur emri i mësuesit/es.		
10	Në programin mësimor ruhen të njëjtat synime ashtu siç paraqiten tek Skeletkurrikuli i drejtimit/profililit profesional.		
11	Në programin mësimor ruhen të njëjtat tema ashtu siç paraqiten tek Skeletkurrikuli i drejtimit/profililit profesional.		
12	Në programin mësimor ruhet e njëjta kohëzgjatje e temave ashtu siç paraqitet tek Skeletkurrikuli i drejtimit/profililit profesional.		
13	Në programin mësimor janë parashikuar orë për provime.		
14	Në programin mësimor janë parashikuar orë për përsëritje.		
15	Në programin mësimor janë parashikuar orë për ushtrime.		
16	Në programin mësimor janë parashikuar orë për punë laborator.		

	1.Programet mësimore hartohet në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulit të drejtimit/profilit profesional dhe udhëzuesve të AKAFPK mbështetur në DN.			
17	Në programin mësimor janë parashikuar orë për vizita mësimore, të ftuar në klasë.			
18	Në programin mësimor janë parashikuar orë për projekte ndërkurrikulare.			
19	Në programin mësimor është përfshirë rubrika tema/kohëzgjatja.			
20	Në programin mësimor është përfshirë rubrika çështjet.			
21	Në përcaktimin e çështjeve janë pasqyruar zhvillimet e fundit dhe standardet e industrisë përkatëse.			
22	Në programin mësimor është përfshirë rubrika koha.			
23	Koha e planifikuar është e mjaftueshme për arritjen e objektivave të synuara.			
24	Në programin mësimor objektivat mësimore janë vënë në përshtatje me kërkesat e lëndës.			
25	Në programin mësimor është përfshirë rubrika instrumentet e vlerësimit.			
26	Instrumentat e vlerësimit janë të përshtatshme dhe mëshketen në objektivat mësimore të përcaktuara në plan.			
27	Në programin mësimor është përfshirë rubrika “vendi”.			
28	Në plan janë përcaktuar mjedise të ndryshme në të cilat do të zhvillohet veprimtaria mësimore.			
29	Në programin mësimor është përfshirë rubrika kërkesat për realizim.			
30	Kërkesat për realizimin e objektivave të vëna janë të mirëmenduara në funksion të specifikave të çështjeve mësimore.			
31	Mësuesi ka planifikuar me fleksibilitet orët mësimore për linjë/nënlinjë/kapitull, në krahasim me programin lëndor për t’iu përshtatur më mirë specifikave të shkollës e nxënësve.			

Objektivat mësimore dhe instrumentet e vlerësimit				
	Kritere vlerësimi:	Po	Jo	shënime
1	Objektivat janë shprehur me folje veprorë që shprehin veprime që mund të demonstrohen nga nxënësi/ja dhe mund të vlerësohen nga mësuesi/ja.			
2	Objektivat mësimore janë shprehur në terma specifikë, të matshëm dhe të vlerësueshëm.			

Objektivat mësimore dhe instrumentet e vlerësimit			
3	Objektivat janë të harmonizuara me temën, çështjet dhe synimet.		
4	Programi mësimor përmban objektiva të tre niveleve të arritjes, sipas taksonomisë së Bloom-it (jo domosdoshmërisht të treja në çdo temë).		
5	Përdoren instrumente të ndryshme vlerësimi për të matur arritjen e objektivave.		
6	Në programin mësimor janë parashikuar instrumente vlerësimi për aftësitë ndërpersonale.		

Kërkesat për realizim			
	Kritere vlerësimi:	Po	Jo
1	Në programin mësimor planifikohen materiale burimore të përshtatshme për realizim e mësimi.		
2	Në programin mësimor është planifikuar përdorimi i pajisjeve digjitale, Dhe platformave sh/ose programeve kompjuterike në ndihmë të arritjes së objektivave mësimore, sipas mundësive të loAFP-së.		
3	Mësuesi ka planifikuar si burim përdorimin e infrastrukturës së shkollës (infotekë, klasa të mësimi të kombinuar) në funksion të realizimit sa më të mirë të mësimi.		

4. Të tjera			
	Kritere vlerësimi:	Po	Jo
1	Në programin mësimor nuk ka gabime drejtshkrimore.		
2	Programi mësimor është punuar me formatet e kërkuara për një dokument, si: tipi i shkrimi, madhësia etj.		
3	Në programin mësimor përdoren shkronjat 'ë' dhe 'ç'.		
4	Në programin mësimor nuk përdoren fjalë të huazuara dhe kur është e nevojshme ato vendosen me shkronja të pjerrëta.		

Komente të përgjithshme			

Fjalorth

Abstraksione - janë ide që njerëzit përdorin për të përshkruar, kuptuar dhe thjeshtëzuar botën. Ato janë në një kuptim, një shabllon mendor që ne përdorim për të perceptuar dhe kuptuar mjedisin.

Aftësi të buta - aftësi karakteri dhe ndërpersonale që karakterizojnë marrëdhënien e një personi me të tjerët. Në punë, aftësitë e buta konsiderohen plotësuese të aftësive të forta, që i referohen njohurive dhe aftësive profesionale të një personi.

Kompetenca - aftësia për të bërë diçka mirë, një aftësi e rëndësishme që është e nevojshme për të kryer një punë.

Kompetenca themelore - janë kompetencat për të cilat kanë nevojë të gjithë individët për plotësim dhe zhvillim vetjak, për qytetari aktive, për përfshirje shoqërore dhe për punësim. (LAPU).

Koncepte - janë ide që i referohen klasave ose kategorive në të cilat të gjithë anëtarët ndajnë disa karakteristika të përbashkëta.

Kornizë kurrikulare - është dokumenti themelor i kurrikulës, ku përshkruhen synimet e përgjithshme të saj, kompetencat themelore, rezultatet e pritshme për nxënësit, për sa i përket dijeve, aftësive dhe qëndrimeve në fund të arsimit bazë dhe atij të mesëm të lartë, synimet e fushave të të nxënies dhe parimet e përgjithshme të procesit të mësimdhënies e nxënies e të vlerësimit të nxënësve (LAPU 69/2012 i ndryshuar).

Kurrikul bërthamë - dokument i rëndësishëm i kurrikulës së arsimit parauniversitar. Ajo miratohet nga MASH-i (për secilin nga tri nivelet arsimore) dhe përmban orientime dhe dispozita të detyrueshme për të gjithë nxënësit. Çdo kurrikul bërthamë përmban rezultatet e të nxënies sipas fushave dhe shkallëve të kurrikulës. Kurrikula bërthamë në klasën X dhe XI është e detyruar dhe e përbashkët për të gjithë nxënësit. Në klasën XII, brenda kurrikulës bërthamë për lëndën “Matematikë”, nxënësit mund të zgjedhin programet sipas niveleve: niveli B (B është niveli bazë) ose niveli A+B (A është niveli i avancuar, që përmban edhe nivelin bazë, pra A+B)

Kurrikula - siguron arsimim cilësor dhe të barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore. Kurrikula është sistem i përbërë nga disa elemente, si: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë, programet mësimore, vlerësimi, që, të lidhura mes tyre, lejojnë të orientohet dhe të funksionojë sistemi arsimor, nëpërmjet planeve arsimore dhe administrative.

Mendim kritik - procesi i të menduarit me kujdes rreth një temë ose ideje, pa lejuar të opinionet dhe ndjenjat etë tjerëve të ndikojnë te ju. **(CD)**

Metoda - një mënyrë e veçantë për të bërë diçka. **(CD)**

Metodë mësimdhënieje - një metodë mësimdhënieje që ngërdhen parimet dhe metodat e përdourar nga mësuesit për të aftësuar nxënësit që të nxënë.

Objektiva - diçka që ju synoni të bëni ose të arrini. **(CD)**

Plan efikas - një mësimdhënie efektive i bën nxënësit të mendojnë dhe i lejon atyre të ndërveprojnë duke bërë pyetje, të rikujtojnë njohuritë që tashmë i dinë dhe të ndërtojnë aftësi të reja. Planifikimi efektiv i mësimit kërkon që mësuesi të përcaktojë tre elementë të rëndësishëm: objektivat, veprimtaritë dhe reflektimin.

Plan mësimor - pasqyra tabelore e lëndëve mësimore dhe fondi i orëve mësimore të paraparë për secilën lëndë mësimore dhe për secilën klasë. (wiki)

Program mësimor - është dokumenti që përmban synimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënit, metodologjitë e të nxënit dhe të vlerësimit për një lëndë ose fushë të caktuar.

Rezultatet e të mësuarit (RM) - kompetencat që duhet te realizohen gjatë procesit mësimor (AKAFP - shprehin ato se çfarë do të arrijë nxënësi që të konsiderohet i suksesshëm, tregojnë në vija të përgjithshme se çfarë do të jetë i aftë të përmbushë nxënësi (f.20, f. 21 29, AKAFP)

Rezultatet mësimore janë thënie që përshkruajnë të nxënësit domethënës dhe thelbësor që nxënësit kanë arritur dhe që mund ta demonstrojnë në fund të një kursi ose programi. Pra, identifikojnë se çfarë nxënësi do të dijë të bëjë në fund të një programi ose kursi.

Shtojca

Neni 54. Ligji 69/2012 i Arsimit Parauniversitar

Drejtori i institucionit arsimor

1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor.
2. Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, është përgjegjës për:
 - a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;
 - b) përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor;
 - c) zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës;
 - ç) menaxhimin e personelit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit.
3. Drejtori i institucionit arsimor publik kryen edhe këto detyra:
 - a) menaxhon institucionin, përfshirë edhe menaxhimin financiar;
 - b) përdor një fond të veçantë vjetor nga buxheti i njësisë arsimore vendore për shpërblimin për merita profesionale të mësuesve, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, pas këshillimit me partnerët socialë dhe bordin e institucionit.

Neni 30 Dispozita Normative

NENI 30

Normativa për arsimin profesional

1. Veprimtaria mësimore në shkollat profesionale mbështetet në skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale, të cilat miratohen nga MASH.
2. Shkollat profesionale, bazuar në skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale, hartojnë kurrikulat shkollore, të cilat miratohen nga drejtori i shkollës, pas pëlqimit nga ekipi lëndor përkatës.
3. Kurrikula shkollore e çdo kualifikimi profesional ka këtë përbërje : a) “Plani mësimor operativ”, i cili hartohet bazuar te “Plani mësimor” që jepet në skeletkurrikulën e kualifikimit profesional përkatës. b) “Planet e mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale”, të cilat hartohen bazuar në “Programet e përgjithshme të lëndëve profesionale” përkatëse. c) “Planet e mësimdhënies së moduleve praktike profesionale” të cilat hartohen bazuar në “Përshkruesit e moduleve profesionale” përkatëse.

4. Skeletkurrikula e një kualifikimi profesional ofron një listë me “module me zgjedhje të detyruar”. Përzgjedhja e tyre bëhet nga vetë shkolla duke konsideruar: a) kërkesat e tregut të punës; b) pëlqimet e nxënësve; c) mundësitë e shkollës.

5. “Plani mësimor shkollor” përshtat planin mësimor të skeletkurrikulës (kombëtare) sipas kushteve dhe mundësive të shkollës dhe merr parasysh numrin e klasave e të mësuesve dhe ndarjen e teorisë me praktikën, duke përcaktuar grafikun e realizimit të moduleve praktike profesionale, si dhe vendin e realizimit të tyre.

6. Modulet e praktikës profesionale mund të realizohen të grupuara (në bllok, me kohëzgjatje 1, 2 ose disa javore) ose të shpërndara përgjatë javëve të vitit mësimor. Ato mund të realizohen në mjediset e praktikave të shkollës ose shkollave të tjera profesionale, gjithashtu në ato të ndërmarrjeve/bizneseve.

NENI 31- Dispozita Normative

Vlerësimi i nxënësve në arsimin profesional

1. Në lëndët teorike profesionale, nxënësi, gjatë vitit shkollor vlerësohet për: a) një ose disa orë mësimore të sapozhvilluara; b) një ose disa tema (kapituj) sipas programit lëndor.

2. Nota vjetore e një nxënësi për lëndët teorike profesionale, njehsohet me formulën: Nota vjetore lëndore = $0,4 \times M1 + 0,6 \times M2$, ku $M1$, $M2$ janë përkatësisht mesataret aritmetike të vlerësimeve për pikat $1/a$ dhe $1/b$, të rumbullakosura me një shifër pas presjes.

3. Në çdo modul praktik profesional, për çdo Rezultat Mësimor (RM), nxënësi vlerësohet gjatë dhe në fund të periudhës që i përket përmbushjes së një RM-je. Nota vjetore e praktikës mësimore përlllogaritet me formulën: ku $M1$, $M2$, $M3$, ..., Mn janë notat e moduleve profesionale dhe $N1$, $N2$, $N3$, ..., Nn janë orët përkatëse të tyre.

4. Në fund të realizimit të çdo projekti, nxënësi vlerësohet për anën teorike dhe praktike (vlerësimin Mp).

5. Për praktikën profesionale në industri/biznes, nxënësi vlerësohet në fund të realizimit të detyrave/projekteve praktike. (vlerësimin Mi).

6. Nota vjetore e një nxënësi për praktikën profesionale Mvp përlllogaritet me formulën: $Mvp = 0.5 \times Mm + 0.4 \times Mi + 0.1 \times Mp$.

7. Nxënësi që ka munguar në më shumë se 30% të orëve të praktikave, në çdo rast, vlerësohet pakalues (pk) dhe humbet vitin.

8. Nxënësi që ka munguar në vlerësimin përfundimtar të një niveli dhe ata që janë mbetës, i nënshtrohen këtij provimi në sesionin e vjeshtës.

NENI 70 Dispozita Normative

Koha e punës së mësuesit në institucionet arsimore publike

- 1) Mësuesit e institucioneve arsimore publike paraqiten në shkollë 15 minuta para fillimit të orarit mësimor të shkollës.
- 2) Drejtuesit dhe mësuesit e institucioneve arsimore publike qëndrojnë 30 orë në javë në mjediset e shkollës ose në mjedise të tjera zyrtare, për të kryer veprimtaritë mësimore dhe jomësimore të planifikuara, duke përfshirë veprimtaritë jashtëshkollore, mbledhjet profesionale, takimet me prindërit dhe pjesëmarrjen në grupet e punës.
- 3) Punonjësi i institucionit arsimor mund të paraqitet në punë me vonesë ose të largohet gjatë kohës së punës vetëm me lejen e drejtorit të institucionit ose të personit të ngarkuar prej tij, në rastet kur drejtori nuk është në institucion.

NENI 71 Dispozita Normative

Plani vjetor lëndor i mësuesit. Aspekte të zbatimit të tij.

1. Pesë ditë para fillimit të vitit shkollor, mësuesi dorëzon planin vjetor lëndor te drejtori i institucionit arsimor.
2. Mësuesi harton planin vjetor lëndor sipas pikëpamjeve të tij pedagogjike dhe në përshtatje me nxënësit e tij.
3. Për çdo kapitull të tekstit, plani vjetor lëndor përmban: objektivat përkatës të programit lëndor, temat njëorëshe për njohuritë e reja dhe temat njëorëshe për përpunimin e njohurive, duke specifikuar llojin e përpunimit (projekte ndër-lëndore/lëndore, përsëritje, vlerësimi i nxënësve dhe të tjera si punët laboratorike).
4. Plani vjetor lëndor përmban përqindjen e orëve mësimore për përpunimin e njohurive të reja kundrejt totalit vjetor të orëve mësimore.
5. Plani vjetor lëndor nuk përmban detyrat e shtëpisë për nxënësit dhe as objektivat e arritjeve të nxënësve për kapitull.
6. Sipas kushteve të klasës, mësuesi është i lirë të parashikojë në planin vjetor ose të realizojë gjatë zbatimit të tij, një luhatje me $\pm 10\%$ të orëve mësimore për linjë/nënlinjë/kapitull, në krahasim me programin lëndor.
7. Gjatë vitit, sipas rrethanave të reja që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin vjetor lëndor. Çdo ndryshim në planin lëndor vjetor shoqërohet me një sqarim të shkurtër.
8. Mësuesi: a) plotëson ato pjesë të programit lëndor që mungojnë në tekstin përkatës që përdor;

b) nuk zhvillon për të gjithë nxënësit ato pjesë të tekstit që nuk parashikohen në programin përkatës lëndor.

9. Mësuesi e ka të ndaluar që për orët e programit të parashikuara për përpunim, të zhvillojë tema që në programin lëndor parashikohen për njohuritë e reja.

NENI 72 Dispozita Normative

Projektet kurrikulare ndërlëndore/ lëndore

1. Temat e projekteve kurrikulare ndërlëndore/lëndore (më tutje në këtë nen “projektet”) përzgjidhen nga nxënësit.

2. Mësuesi udhëzon nxënësit para dhe gjatë zhvillimit të projektit, vëzhgon qëndrimin dhe kontributin në projekt të secilit nxënës-pjesëmarrës gjatë punës individuale e në grup dhe vlerëson nxënësit.

3. Drejtori i shkollës nxit mësuesit të punojnë për projekte ndërlëndore.

4. Projekti ka aspak ose shumë pak shpenzime dhe nuk kërkon shpenzime nga prindërit.

5. Në projekte është e dëshirueshme të përfshihen edhe prindër.

6. Mësuesi përshkruan përmbledhtas projektin kurrikular sipas një formati me këto rubrika: Titulli i projektit, objektivat e projektit, temat e njohurive kryesore lëndore të cilat do të rimerren në sajë të projektit, partneret (nëse ka, si: prindër, OJF), numri i orëve gjithsej të projektit dhe i ndarë në mes të mësuesve, numri i nxënësve që përfshihen në projekt ose numri i klasave, përshkrimi i shkurtër i veprimtarive kryesore të projektit; përshkrimi i shkurtër i produktit të projektit; mënyra e prezantimit përfundimtar të projektit.

7. Në orarin mësimor të klasës shënohen ato orë mësimore të projektit që zhvillohen në klasë (përzgjedhja e projektit, një pjesë e punës së nxënësve në projekt dhe prezantimi i projektit)

8. Mësuesi (mësuesit) planifikojnë një numër orësh të mjaftueshme për realizimin cilësor të projektit.

9. Orët mësimore të projekteve përfshihen në ngarkesën mësimore vjetore të mësuesve përkatës.

10. Orët mësimore të projektit shënohen në regjistër si orët e tjera lëndore.

11. Kur projekti është ndërlëndor, secili mësues bën vlerësimin e nxënësve për pjesën e lëndës së tij ku nxënësit janë përfshirë.

12. Institucioni arsimor krijon arkivin e projekteve më të mira, të cilat mësuesit i shfrytëzojnë përgjatë viteve. Arkiva është objekt inspektimi nga ISHA dhe vëzhgimi nga DAR/ZA-ja për përhapjen e përvojave të suksesshme.

NENI 73 Dispozita Normative

Plani ditor (ditari) i mësuesit

1. Mësuesi harton planin (ditarin) e çdo ore mësimore.
2. Plani i çdo ore mësimore përmban këto rubrika: Tema e orës mësimore, data e zhvillimit të orës mësimore, objektivi ose objektivat e orës mësimore, mjetet mësimore të veçanta për orën mësimore; përshkrimi i shkurtër për mënyrën se si mësuesi parashikon përmbushjen e objektivit (objektivave); detyrat e shtëpisë, të paraqitura në mënyrë që nxënësve t'u mundësohet diferencimi i punës sipas mundësive dhe interesave.
3. Mësuesi paraqet në planin ditor (ditar), herë pas here, këto rubrika: a) Përshkrimi i shkurtër i mënyrave të vlerësimit të nxënësve, kur e ka parashikuar këtë vlerësim. b) Testet e zhvilluara. c) Shënime-refleksione, si: koncepte a njohuri që duhen theksuar përsëri, për nxënësit në përgjithësi ose për nxënës të veçantë; punët plotësuese me nxënës të caktuar etj. Nuk është e detyrueshme që: a) objektivat të përshkruhen në nivele; b) plani i orës mësimore të përmbajë shtjellimin e përmbajtjes së temës mësimore.
4. Për klasat paralele me një klasë, plani i orës mësimore mund të përmbajë vetëm veçoritë e zhvillimit të orës mësimore, nëse ka të tilla.
5. Mbajtja e planit ditor dhe respektimi i rubrikave janë objekt i kontrollit nga drejtuesit e institucionit arsimor, specialistët e kurrikulës së njësive arsimore vendore dhe i inspektimit nga ISHA.
6. Mësuesi e ruan planin ditor të një klase për 1 (një) vit shkollor.

Bibliografi

Borich, D. G (2004), Effective Teaching Methods, Pearson Merrill Prentice Hall

Edward T, Clark, JR, (2001), Designing and Implementing an Integrated Curriculum, a Student-Centered Approach, Holistic Education Press, Brandon VT

Jacobsen. D, Eggen.P, Kauchak. D, (2000) Methods of Teaching, Promoting Students Learning K-12 classrooms, Pearson Merrill Prentice Hall

<https://skillsforjobs.al/wp-content/uploads/2020/09/UDHEZUES-PER-ORGANIZIMIN-E-MESIMIT.pdf>

<http://arsimiparauniversitar.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Udher-Nr.-31-date-28.01.2020-Rregullore-per-IAP.pdf>

[http://www.akafp.gov.al/ëp-](http://www.akafp.gov.al/ëp-content/uploads/2014/09/20100205075424)

[content/uploads/2014/09/20100205075424](http://www.akafp.gov.al/ëp-content/uploads/2014/09/20100205075424) udhezues per hartimin e kurrikulave te afp ne shqiperi1.pdf

<https://dictionary.cambridge.org/>

<https://www.ascap.edu.al/>

<https://www.vendime.al/ligj-nr-692012-per-sistemin-arsimor-parauniversitar-ne-republiken-e-shqiperise/>

<https://www.wikipedia.org/>

<https://www.ascap.edu.al/>

www.lamission.edu/